



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RAPORTI VJETOR

2015

Misioni, objektivat, funksionet kryesore

Misioni i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është mbikëqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar jobankar në Shqipëri. Ky mision udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit. Roli rregullator dhe regjimi mbikëqyrës i AMF-së, synon nga njëra anë stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve të sigurimeve, kapitaleve dhe pensioneve private e nga ana tjetër mbrojtjen e konsumatorit, mision i cili realizohet përmes forcimit të kapaciteteve menaxhuese, sigurimit të shumëllojshmërisë dhe konkurrencës së ndershme të operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe të një kuadri reagues e më të efektshëm për mbikëqyrjen.

AMF u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si institucion juridik publik, i pavarur që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Ky ligj pësoi ndryshime në vitin 2014, ndryshime të cilat hynë në fuqi në muajin korrik të këtij viti, ku risia kryesore ishte fuqizimi i pavarësisë së AMF-së, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë për realizimin e misionit të tij. Pavarësia institucionale dhe financiare e AMF-së, si element i rëndësishëm që kontribuon në nxitjen e qëndrueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje dhe kusht për zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre, ishte në themel të këtij ligji, zbatimi i të cilit filloi në vitin 2015. Kështu, ndryshimi i Ligjit nr. 9572, i shoqëruar nga ndryshimet në dy ligjet e tjera, si ligji për pagat dhe ligji për strukturat e institucioneve të pavarura dhe të shërbimit civil, bënë të mundur:

- *Rritjen e pavarësisë institucionale*, e cila konsistoi në riformatimin e strukturës së funksionimit të AMF-së, duke reflektuar zhvillimin dinamik të tregjeve financiare jobankare, veçanërisht atë të fondeve të investimeve. Në prill të 2015, Bordi i ri i AMF-së me Vendimin nr. 27, datë 28.04.2015 miratoi strukturën e re të institucionit.
- *Rritjen e pavarësisë financiare*, e cila konsistoi në të drejtën e Autoritetit për krijimin e fondit të rezervës si mekanizëm për të përballuar shpenzimet e veprimtarisë në rastin e mungesës së të ardhurave, duke rritur pavarësinë nga buxheti i shtetit dhe miratimin e politikës dhe sistemit të pagave, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare të organeve drejtuese dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje;
- Sigurimi i respektimit të ligjit.

Funksionet kryesore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja:

- E tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- E tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- E tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg;
- E veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.

Bordi i AMF-së

Me Ligjin nr. 54/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” Bordi u rikonceptua. Ai përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë, kryetari, drejtori i përgjithshëm ekzekutiv, nëndrejtori ekzekutiv dhe dy anëtarë të tjerë.

Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një periudhë 5-vjeçare me një të drejtë rizgjedhjeje. Bordi i parë që emërohet pas hyrjes në fuqi të amendimeve është përcaktuar me mandatet e mëposhtme të shkallëzuara (neni 24 i amendimit):

- Kryetari i Bordit, 4 vjet;
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, 5 vjet;
- Nëndrejtori Ekzekutiv, 4 vjet;
- Anëtarët e tjerë, 3 vjet.

Me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, më 24 dhjetor 2014 janë emëruar Znj. Enkeleda Shehi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, propozim i Këshillit të Ministrave, Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv, propozim i Ministrit të Financave dhe Z. Arian Salati, anëtar i Bordit, propozim i Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe Administratës Publike.

Z. Pajtim Melani, është emëruar Kryetari i Bordit, propozim i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në datën 12 mars 2015. Gjatë vitit 2015 Bordi funksionoi me 4 anëtarë. Anëtar i fundit i Bordit, Z. Klodion Shehu, si propozim i Bankës së Shqipërisë, u miratua me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, më 28 janar 2016

Përmbajtja:

Kapitulli 1	Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje	6
1.1	Prirjet në tregjet financiare	6
1.2	Tregu i sigurimeve	7
1.3	Tregu i letrave me vlerë	35
1.4	Tregu i pensioneve private vullnetare	42
1.5	Masat korrigjuese dhe administrative	46
Kapitulli 2	Rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje	49
2.1	Veprimtaria e Bordit të AMF-së	49
2.2	Aktiviteti rregullator	50
2.3	Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje	56
Kapitulli 3	Qeverisja dhe mbrojtja e konsumatorit	61
3.1	Qeverisja dhe sjellja në treg	61
3.2	Mbrojtja dhe edukimi i konsumatorëve	67
3.3	Qendra e Edukimit	69
Kapitulli 4	Transparenca dhe bashkëpunimi institucional	71
4.1	Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun	71
4.2	Bashkëpunimi institucional	73
Kapitulli 5	Organizimi i brendshëm	83
5.1	Pasqyrat financiare	83
5.2	Struktura organizative dhe burimet njerëzore	86
5.3	Kuadri rregullator i AMF-së	90
5.4	Teknologjia e informacionit	91
Sfida dhe projekte të ardhshme, 2015-2016		92
SHTOJCA		
A:	Struktura e AMF-së	
B:	Lista e institucioneve të mbikëqyrura	
C:	Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara nga AMF	
D:	Përmbyllja e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë financiare për vitin 2015	
E:	Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	

Kapitulli 1

Ecuria e tregjeve financiare nën mbikëqyrje

1.1 Prirjet në Tregjet financiare

Tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF gjatë vitit 2015 ruajtën të njëjtën strukturë nga pikëpamja e totalit të aktiveve si në vitin 2014. Madje, ato përforcuan prirjen e vërejtur gjatë periudhës 2012-2014 në drejtim zgjerimit të aktivitetit dhe rritjes së peshës së tregut të fondeve të investimeve.

Në tërësi, tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF kanë vijuar dinamikën e zgjerimit të tyre. Totali i aseteve të këtyre tregjeve në 31.12.2015 arriti në 95.7 miliardë lekë, rreth 6.7% kundrejt Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ose me rritje 7% kundrejt vitit 2014. Dinamika e zgjerimit vërehet për të tre tregjet financiare të mbikëqyra nga AMF.

Kështu, tregu i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, me total aktivesh që luhet në intervalin 1.3-1.7% e PBB-së për periudhën 2005-2014 dhe 1.9% e PBB-së në vitin 2015. Zgjerimi ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto, kryesisht në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Por pavarësisht këtij zgjerimi të tregut të sigurime, pesha e tij në tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF është në nivele afërsisht të njëjta, përkatësisht 30.0%, 27.4% dhe 28.9% për vitet 2013-2015.

Tregu i fondeve të investimeve e filloi aktivitetin në vitin 2012 duke zënë përkatësisht 69.4%, 71.9% dhe 70.2% të peshës së tregjeve që mbikëqyren nga AMF, ose 3.7%, 4.6% dhe 4.7% e PBB-së për periudhën 2013-2015. Nisur nga treguesi i nivelit të aktiveve gjithsej ndaj PBB-së rezulton që në sistemin financiar shqiptar, tregu i dytë më i rëndësishëm pas tregut bankar konsiderohet tregu i fondeve të investimeve.

Përsa i takon tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe veprimtarive të tjera financiare jobankare vërehet një prirje në rritje e qëndrueshme, por që gjithsesi mbetet modeste.

Ky profil strukturor i tregjeve financiare që mbikëqyren nga AMF dhe raporti i tyre me tregun bankar shërben për të ravijëzuar ndryshimin që po pësojnë rreziqet në tregjet financiare dhe reagimin mbi këtë bazë të Autoritetit.

Megjithëse profili i rrezikut të tregjeve që mbikëqyren nga AMF ka pasur ndikim relativ të ulët në sistemin financiar shqiptar, tashmë ai nuk mund të konsiderohet i papërfillshëm si disa vite më parë, e për rrjedhojë analizohet në kuadër të rreziqeve sistematike për sistemin financiar në

tërësi dhe është në vijimësi pjesë e diskutimeve që kryhen në kuadër të Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF).


AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregjet financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, si dhe pensioneve private vullnetare apo veprimtarive të tjera financiare jobankare, ka për mision të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Kjo dikton nevojën e:

- Vijimit të zbatimit të *masave stabilizuese në tregun e sigurimeve* dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, si dhe zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku;
- Forcimin e *rregullave të administrimit të rrezikut të fondeve të investimeve* në harmoni me evoluimin e rregullave të përshkruara në Direktivat përkatëse të BE-së, duke mbikëqyrur ngushtësisht respektimin e regjimit të informimit të klientëve të këtyre fondeve, nivelet e likuiditetit, si dhe vlerësimin real të aseteve;
- Nxitjes së *zhvillimit të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare private dhe përmirësimit të mbikëqyrjes* së këtij tregu;
- *Konfigurimin e mbikëqyrjes së konsoliduar* me autoritete të tjera rregullatore, kryesisht me Bankën e Shqipërisë (BSH), dhe hartimit të kuadrit të integruar të masave për administrimin e situatave problematike/krizës për sistemin financiar në vend, në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF).

1.2 Tregu i Sigurimeve

Gjatë vitit 2015 tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje të ndjeshme nga pikëpamja e vëllimit total të primeve të shkruara bruto, të cilat kapën shifrën 14.09 miliardë lekë, duke u rritur me afro 21.17% krahasuar¹ me vitin 2014 dhe me një rritje mesatare në pesë vitet e fundit prej 12.37%. Nga pikëpamja e numrit të shoqërive operuese në këtë treg, gjatë vitit 2015, nuk pati ndryshime.

¹ Krahasimi është bërë me shifrat e raporteve të audituara të vitit 2014.

Grafik 1: Ecuria e primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara bruto në vite*(Në mln. lekë)***Tabela 1: Shoqëri sigurimi të licencuara sipas klasave të sigurimit, 2010-2015***(Në numër)*


Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Sigurim Jo-Jetë ²	7	7	7	8	8	7	7
Sigurim Jetë	2	2	2	2	2	2	2
Miks (Jetë dhe Jo-Jetë) ³	1	1	1	1	1	1	1

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 92.61% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 7.30% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë 2015, sigurimet vullnetare zunë 39.76% dhe ato të detyrueshme zunë 60.24% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

² Një nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës kryen edhe veprimtarinë e risigurimit. (SIGAL Uniq Group Austria sh.a.)

³ INSIG sh.a. - Shoqëria e vetme me kapital tërësisht shtetëror që ushtron veprimtarinë e sigurimit prej më shumë se 20 vitesh në tregun shqiptar, ushtron veprimtari në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës.

Grafik 2: Struktura e tregut të sigurimeve, 2015



Gjatë vitit 2015, rritja e tregut të sigurimeve është e ndikuar kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve të detyrueshme motorike.

Tabela 2: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi vjetor, 2013-2015


Veprimtaria	Primet e shkruara bruto (mln. lekë)			Ndryshimi në %	
	2013	2014	2015	2014/2013	2015/2014
Jeta	960	1,026	1,028	6.90	0.19
Jo-Jeta	7,524	10,570	13,043	40.49	23.39
Risigurimi	54	27	13	(49.36)	(52.47)
Total	8,538	11,623	14,084	36.14	21.17

Dendësia e sigurimit⁴

Dendësia e primit të sigurimit për frymë, është një tregues që shpreh shkallën e përdorimit të produkteve të sigurimit nga popullsia. Në vitin 2015, primi për frymë ishte mesatarisht 4,880 lekë (34.92 euro), me një rritje prej 861.36 lekë krahasuar me një vit më parë. Primi për frymë në sigurimin e Jo-Jetës ishte mesatarisht 4,519 lekë (32.34 euro).

⁴ Popullsia 01.01.2014, marrë nga faqja zyrtare e INSTAT, <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>

Grafik 3: Primi i sigurimit për frymë në vite, 2006-2015



Analiza Financiare

Në zbatim të kuadrit rregullator ekzistues, edhe gjatë vitit 2015, AMF ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Fondi i Garancisë

Fondi i garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në Nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t'u disponuar nga siguroesi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në "depozita qëllimore" me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono

Totali i fondeve të bllokuara për fondin e garancisë për tregun është në vlerën 5,7 miliardë lekë më 31.12.2015. Gjatë vitit 2015 ky fond është investuar në depozita pranë bankave tregtare dhe në letra me vlerë, përkatësisht në masën 73.3% dhe 26.7%.

Tabelë 3: Struktura dhe dinamika e aktivitetit dhe pasivitetit të tregut të sigurimeve⁵

Emërtimi	31.12.2013	31.12.2014	31.12.2015
	struktura (në %)		
Depozita	37.81	36.26	36.00

⁵ Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbështetur në bazën ligjore të AMF-së.

Toka dhe ndërtime	9.25	7.93	7.21
Aksione dhe pjesëmarrje	12.11	10.92	11.18
Bono thesari dhe obligacione	7.41	10.85	11.52
Debitorë	10.21	8.88	7.93
Aktive të tjera	23.22	25.16	26.16
Totali i Aktivit	100.00	100.00	100.00
Provigjonet teknike bruto	41.23	45.16	50.76
Detyrime të tjera	13.38	13.32	12.28
Kapitalet e veta	45.39	41.62	36.96
Totali i Pasivit	100.00	100.00	100.00
<i>Emërtimi</i>	<i>31.12.2013</i>	<i>31.12.2014</i>	<i>31.12.2015</i>
<i>dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>			
Depozita	97.94	107.20	110.43
Toka dhe ndërtime	103.69	95.82	101.08
Aksione dhe pjesëmarrje	100.60	100.84	131.82
Bono thesari dhe obligacione	123.24	163.63	118.19
Debitorë	109.22	97.21	99.35
Aktive të tjera	126.32	121.09	115.68
Totali i Aktivit	107.18	111.76	112.92
Provigjonet teknike bruto	110.08	122.16	125.30
Detyrime të tjera	147.61	111.25	102.58
Kapitalet e veta	97.03	102.47	102.45
Totali i Pasivit	107.18	111.76	112.92

Nga shqyrtimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën 3 dhe 4 (me poshtë), mbështetur në të dhënat e raportimit financiar të datës 31.12.2015, konstatohet se:

Aktivet e tregut të sigurimeve më 31.12.2015 krahasuar me 31.12.2014, u rritën me 3.16 miliardë lekë ose 12.92%, me një ritëm rritjeje më të lartë krahasuar me vitin 2014. Investimet në depozita në institucione krediti dhe bono thesari e obligacione dominuan në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit me 48.53%. Krahasuar me vitin 2014, rritja e investimeve likuide si depozita në institucione krediti dhe bono thesari ishte masën 12.22%. Gjithashtu, rritje në aktivet e tregut të sigurimeve kanë pësuar edhe zërat si parapagime e të ardhura të llogaritura, provigjoni teknik i risiguruesit, dhe aktive të tjera.

Kapitalet e veta të shoqërive të sigurimit u rritën me 2.45% krahasuar me 31.12.2014, si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës, rritjes së rezervave të rivlerësimit të kapitalit si dhe shtesës së kapitalit themeltar. Ndërkohë provigjonet teknike bruto në 31.12.2015 janë rritur me 25.3% ose 2.8 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2014.

Tabelë 4: Të dhëna financiare të tregut të sigurimeve

(Në mln. lekë)

<i>Periudha Ushtrimore</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Totali i aktiveve	19,013	20,343	21,839	24,451	27,610
Jeta	2,884	3,207	3,788	4,009	3,857
Jo-Jeta	16,130	17,136	18,051	20,442	23,752
Totali i investimeve	12,855	13,692	14,082	15,721	18,996
Jeta	2,201	2,748	2,971	2,684	2,904
Jo-Jeta	11,492	11,334	12,750	15,175	16,092
Provigjonet teknike bruto	7,634	8,317	9,650	11,191	14,014
Jeta	942	1,175	1,522	1,529	1,605
Jo-Jeta	7375	8,475	9,669	11,486	12,409
Totali i kapitalit	9,867	10,005	9,173	9,954	10,204
Jeta	1,791	1,899	2,195	1,988	1,782
Jo-Jeta	8,076	8,105	6,978	7,966	8,421
Totali i kapitalit të nënshkruar	7,736	8,247	8,652	8,152	8,190
Jeta	1,284	1,351	1,355	1,217	1,221
Jo-Jeta	6,963	7,301	6,797	7,339	6,969
Totali i investimeve të huaja	3,472	3,592	3,435	3,620	3,807
Jeta	398	458	442	468	496
Jo-Jeta	3194	2,977	3,178	3,447	3,311
Primi i fituar neto	6,792	6,736	6,101	7,763	9,988
Jeta	823	890	957	686	950
Jo-Jeta	5,913	5,211	6,806	6,717	9,038

Tabelë 5: Teste IRIS për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës

(Në %)

<i>Raporti</i>	<i>31.12.2013</i>	<i>31.12.2014</i>	<i>31.12.2015</i>	<i>Kufiri</i>	
				<i>MIN</i>	<i>MAX</i>
Norma e rritjes së primit	-6.10	39.85	23.43	-40	40
Raporti i mbajtjes neto	67.45	76.93	78.64	40	80
Raporti dëme/prime neto	49.87	36.43	38.75	50	80
Raporti i shpenzimeve	79.94	57.69	61.91	25	50
Raporti i kombinuar	129.81	94.12	100.66	85	105
Të ardhurat nga investimet	10.81	5.87	4.87	4	8
Raporti operativ	117.49	83.09	95.79	n/a	100
Raporti i kapitalit	43.76	29.25	24.29	20	50
Raporti i provigjoneve teknike	52.31	43.93	34.62	10	30
Raporti i aftësisë paguese	290.05	196.27	180.78	150	300

Referuar të dhënave të tabelës 5, vërehet se:

Norma e rritjes së primeve në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës gjatë vitit 2015 është 23.43%, brenda kufijve të lejuar. Në vitin 2014 norma e rritjes së primeve pësoi një rritje të konsiderueshme, si rezultat i stabilizimit të primeve të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, ndërkohë gjatë 2015, norma e rritjes së primeve ka qenë më modeste.

Raporti i mbajtjes neto në tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 78.64%. Ky raport është rritur në krahasim me periudhat paraardhëse, duke qënë brenda kufirit të lejuar.

Raporti dëme/prime për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në 2015 është në vlerën 38.75%, duke pësuar një rritje në krahasim me fundin e vitit 2014. Rritjet e këtij treguesi kanë ndodhur kryesisht gjatë tremujorit të parë dhe tremujorit të fundit të vitit 2015. Në rritjen e raportit dëme/prime për tregun e sigurimeve jo-jetë, gjatë vitit 2015, ka ndikuar rritja me ritme më të larta në dëmet e paguara neto, ndërkohë që primet e fituara neto kanë shfaqur ritme rritjeje më të ngadalta.


Raporti i shpenzimeve për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në 2015 është në masën 61.91%. Ky raport megjithëse ka pasur një tendencë në rënie gjatë vitit 2015, përsëri tejkalon normat e përcaktuara ndërkombëtare.


Raporti i kombinuar për tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 100.66%, tregues ky i rezultateve financiare pozitive të tregut të Jo-Jetës në aktivitetet operacionale. Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti i kapitalit ndaj Provigjoneve Teknike, për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, ka pasur një tendencë në rënie gjatë vitit 2015. Në 31.12.2015 ky raport është rritur në 34.62%, krahasuar me 43.93% që ka qenë në 31.12.2014.

Grafik 4: Treguesit IRIS (sipas shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës)

31.12.2015





Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve sipas mbikëqyrjes me fokus rrezikun

Gjatë 2015, AMF vazhdoi inspektimin në vend në një nga shoqëritë e sigurimit sipas metodologjisë së re me fokus rrezikun. Staf i AMF-së u përqendrua në strukturimin e procedurave të inspektimit dhe hartimin e planit të intervistave me të gjitha nivelet e menaxhimit të shoqërisë. Gjatë inspektimit u diskutua lidhur me rreziqet e pranishme në shoqëri sipas aktiviteteve të biznesit, si edhe menaxhimit të tyre nga drejtuesit e lartë të shoqërisë.

Objekti i këtij inspektimi u përqendrua në:

- Vlerësimin e riskut të kreditit në marrëdhënie me risiguruesit, mbledhjen e primeve dhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e riskut të sigurimit, duke u përqendruar kryesisht tek marrja në sigurim dhe risqet e përgjegjësisë, si edhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut operacional, duke u përqendruar tek provigjonet, vlerësimi i dëmeve, procedurat e trajtimit të dëmeve, sistemet e teknologjisë së informacionit, performanca operationale, si edhe të tjera aktivitete të lidhura me to;
- Vlerësimin e rrezikut rregullator dhe strategjik, në drejtim të vlerësimit të Fondit të Garancisë;
- Vlerësimin e fuqisë së kapitalit dhe cilësisë së fitimeve;
- Vlerësimin e elementëve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë;
- Menaxhimin e rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen nga drejtimi të veprimtarisë së shoqërisë.

Në fund të këtij procesi, Autoriteti hartoi profilin e rrezikut për këtë shoqëri, që përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e shoqërisë, brenda kontekstit të tregut të sigurimeve në përgjithësi. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet në përgjegjësinë e

Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë së sigurimit, duke ju përmbajtur politikave dhe praktikave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, për të zbutur rreziqet e konsiderueshme që shoqërojnë këtë biznes.

Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë e sigurimeve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri sigurimi.

Zbatimi i kësaj metodologjie është një sfidë e madhe jo vetëm për tregun e sigurimeve, por edhe për Autoritetin dhe punonjësit e tij të mbikëqyrjes. Kjo pasi krahasuar me qasjen tradicionale, mbikëqyrja me fokus rrezikun kërkon që mbikëqyrësi të kuptojë shumë mirë konceptet financiare, të ketë njohuri të thella për operacionet e siguruesit, të kuptojë shumë mirë rreziqet e biznesit dhe sigurimit. Njëkohësisht ajo kërkon që mbikëqyrësi dhe ekipi drejtues i shoqërive të mbikëqyrura, të koordinojnë operacionet e biznesit dhe planet e ardhshme, meqenëse këta janë drejtuesit, vendimet e të cilëve do të ndikojnë në rezultatin e ardhshëm të kësaj shoqërie.

Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2015, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (*Financial Sector Reform and Strengthening Initiative*) AMF ka punuar për zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën e tregut të sigurimeve.

Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, kohë e cila është kërkuar të zgjatet nga Banka Botërore deri në fund të muajit mars 2017, dhe përmban tre komponentë kryesorë të cilat janë:

- Sigurimi i produktit MTPL;
- Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme;
- Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.

Inspektim lidhur me Fondin e Kompensimit

Gjatë vitit 2015, AMF ka kryer inspektim pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS). Fokusi i inspektimit në shoqëritë e sigurimit ishte verifikimi i pagesave të kryera gjatë viteve 2014 dhe 2015 për dëmet e prapambetura të Fondit të Kompensimit me ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013, në zbatim të kërkesave të vendimeve të Bordit të AMF-së nr. 17, datë 28.02.2014 dhe nr. 12, datë 20.03.2015. Ndërsa në BSHS fokusi i inspektimit ishte verifikimi i të dhënave të detajuara të dëmeve të Fondit të Kompensimit për dëmet me ngjarje sigurimi deri në 31.12.2015 si dhe raportimit të BSHS në AMF lidhur me dëmet e paguara gjatë viteve 2014 dhe 2015, që i përkasin dëmeve me ngjarje sigurimi deri në 31.12.2015. Nga gjetjet e këtij inspektimi AMF ka lënë rekomandimet përkatëse.

Inspektime të përbashkëta me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, AMF ka kryer gjatë vitit 2015, dy inspektime të përbashkëta. Një në shoqëri sigurimi jetë dhe një në shoqëri risigurimi. Fokusi i inspektimit ishin verifikimet lidhur me respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

Nga ky inspektim u konstatua se shoqëria e sigurimit të jetës ka kryer kundravajtje administrative të cilat i referohen Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Për këtë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka marrë masë administrative me gjobë kundrejt shoqërisë.

Inspektime të përbashkëta u kryen edhe për tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së që pasqyrohen në kapitujt përkatës.

Inspektime të përbashkëta për mbikëqyrje të konsoliduar të tregjeve financiare

Në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, dhe në zbatim të rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) për një mbikëqyrje të konsoliduar të tregjeve financiare, AMF ka kryer gjatë vitit 2015, një inspektim të përbashkët në bankat e nivelit të dytë. Fokusi i AMF-së në inspektimin e përbashkët për tregun e sigurimeve ishin verifikimet lidhur me:

- Ekspozimin agregat të shoqërive të sigurimit për produktet e sigurimit të garancive bankare;
- Depozitat, kreditë e marra nga shoqëritë e sigurimit pranë bankave të nivelit të dytë, si edhe kolaterale të garantuara prej tyre;
- Verifikimin e praktikave të dëmeve pezull që rrjedhin nga të gjitha llojet e policave të sigurimit me përfitues bankat.
- Verifikim i marrëdhënieve të shoqërive të sigurimit me bankën e nivelit të dytë.

Provigjonet Teknike

Në kuadrin e analizës financiare, me qëllim mbikëqyrjen e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, AMF vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike, ndër vite, shfaq një tendencë në rritje. Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, duke reflektuar edhe strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Provigjoni Teknik dhe testet e mjaftueshmërisë

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguruesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provigjonet teknike, mbështetur në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Disa nga testet aktuariale të cilat shqyrtohen me qëllim vlerësimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike bruto të shoqërisë së sigurimit janë;

LAT – testi i mjaftueshmërisë së provigjoneve të primit të pafitur;


Run-off – testi i mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të dëmeve.

Në varësi të rezultatit të përfituar nga këto teste, vlera e përllogaritur e provigjoneve teknike të shoqërisë së sigurimit korrigjohet në mënyrë që niveli përfundimtar i këtij treguesi të reflektojë drejtë nivelin e pritshëm të detyrimeve të ardhshme të shoqërisë së sigurimit.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjoni teknik të dëmeve dhe primeve, duke reflektuar edhe përpjekjet e vazhdueshme të Autoritetit në drejtim të përmirësimit të këtij treguesi. Veçanërisht, AMF në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjoni teknik të dëmeve në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni i marrë nga palë të treta (gjykatat për dëmet në proces gjyqësor) lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë.

Grafik 5: Provigjoni Teknik Bruto

(Në mijë. lekë)




Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë gjithashtu se peshën më të lartë nga komponentët e këtij treguesi e përbën provigjoni teknik bruto nga aktiviteti i Jo-Jetës, në linjë dhe me zhvillimin aktual të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë gjithashtu se peshën më të lartë nga komponentët e këtij treguesi e përbën provigjoni teknik bruto nga aktiviteti i Jo-Jetës, në linjë dhe me zhvillimin aktual të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2015 ky tregues paraqitet në nivelin 67% të totalit të Provigjoni teknik bruto të Jo-Jetës krahasuar me 79% për 31.12.2014.

Grafik 6: Struktura e provigjoneve teknike për MTPL




Siç vërehet edhe në grafikun e mësipërm, struktura e provigjoneve teknike bruto për portofolin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, MTPL paraqet një trend pothuajse konstant të raportit që mbajnë provigjonet teknike të dëmeve dhe ato të primit të pafituar kundrejt totalit të provigjoni teknik bruto. Për 31.12.2015 ky raport paraqitet pothuajse i pandryshuar me 31.12.2014 ose në raportin 52% me 48%, përkatësisht raporti i provigjoneve teknike të dëmeve dhe ato të primit të pafituar kundrejt totalit të provigjoni teknik bruto në nivel tregu për produktet MTPL.

Sigurimi i Detyrueshëm Motorik


Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë vitit 2015, shënoi rritje të primeve të shkruara bruto me rreth 22.50% krahasuar me vitin 2014, duke vazhduar të zërë peshën kryesore në këtë treg. Ai solli pjesën më të madhe të të ardhurave, ose 64.98% të totalit të primeve të shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës.

Në sigurimin e detyrueshëm motorik, portofoli me rritjen më të madhe rezultoi MTPL e brendshme, me rritje prej 27.52% të primeve të shkruara bruto, krahasuar me një vit më parë.

Grafik 7: Struktura e primeve të shkruara bruto të tregut të Jo-Jetës, 2015




Grafik 8: Sigurimi motorik, primet e shkruara bruto 2006-2015



Nga krahasimi i të dhënave të primit mesatar për sigurimin e detyrueshëm motorik me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria ka një nivel primi që është më i ulët në rajon.

Grafik 9: Primi mesatar i sigurimit të detyrueshëm motorik⁶

(Në euro)



Dëmet


Gjatë vitit 2015, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 3.64 miliardë lekë dëme⁷, ose rreth 28.16% më shumë se në vitin 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me rreth 2.2 miliardë lekë, apo 60.37% të totalit.

⁶ Të dhënat janë marrë nga faqja online www.xprimm.com

⁷ Dëme të paguara bruto, sipas të dhënave statistikore, jo sipas pasqyrave financiare (Këto pasqyra depozitohen në AMF më 31.03.2016).

Grafik 10: Dëmet e paguara bruto të sigurimit të detyrueshëm motorik

(Në mln. lekë)



Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

AMF, edhe gjatë vitit 2015, ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e detyrimeve të BSHS, lidhur me zbatimin e Marrëveshjes Uniforme dhe të Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove.

Gjatë vitit 2015, pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë raportuar tetë thirrje garancie, përkatësisht një thirrje garancie nga Byroja e Rumanisë, një thirrje nga Byroja e Belgjikës, dy thirrje nga Byroja e Zvicrës, të cilat janë paguar brenda afateve të Rregulloren e Këshillit të Byrove, ndërsa katër thirrjet e Byrosë Greke, janë raportuar në muajin dhjetor 2015, për të cilat ka vijuar procesi për pagesë.

Byroja Shqiptare e Sigurimeve

Në bazë të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, anëtar i Byrosë është çdo sigurues, i cili është i licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm motorik dhe sigurimin e pasagjerëve në transportin publik.

Deri në fund të vitit 2015, në përbërje të BSHS-së ishin anëtarë 8 shoqëri sigurimi.

Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove (Shoqata Ndërkombëtare e Byrove Kombëtare të Siguruesve Motorik) dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartanit Jeshil, si dhe kryen funksionet e entit kompensues për bërjen e pagesave që përballohen nga Fondi i Kompensimit.

Aktualisht detyrimet për pagesat e Fondit të Kompensimit janë në vlera të konsiderueshme dhe procesi për shlyerjen e këtyre detyrimeve po ndiqet me përparësi duke ndjekur si procesin e pagesave nga ana e shoqërive të autorizuar për pagesë si dhe procesin e shlyerjeve të detyrimeve duke i dhënë përparësi periudhës më të hershme të ngjarjes së sigurimit.

Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së BSHS dhe me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit, ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit (FK) dhe kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i këtij Fondi.


Fondi i Kompensimit

Qëllimi për krijimin dhe mbajtjen e FK-së është pagesa e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti të pasiguar, të pidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie sigurimi. Burimet e financimit të Fondit të Kompensimit parashikohen në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 dhe krijohen nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik;
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet të Byroja;
- Gjokat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

Grafik 11: Fondi i Kompensimit i miratuar nga AMF për vitet 2010-2015

(Në mln. lekë)



Në vazhdim të angazhimit për përmbushjen e detyrimeve, sipas rekomandimeve bazë të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, AMF, në mars të vitit 2015, ka miratuar fondin e kompensimit të ndarë përkatësisht:

- Fond për shlyerjen e detyrimeve për dëme pezull deri më 31.12.2013, në vlerën 450 milionë lekë;
- Fond për pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, duke filluar minimalisht nga vlera 20 milionë lekë, vlerë e cila i shtohet pjesës së pakonsumuar të fondit të kompensimit të vitit 2014, e krijuar për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2015, pagesat e dëmeve objekt i fondit të kompensimit nga shoqëritë e sigurimit janë realizuar në masën në masën 94%. Shkaku i mosplotësimit të detyrimit të përcaktuar në Vendim është se dy shoqëri sigurimi, kanë ankumuar në gjykatë ndarjen e vlerës së detyrimit për fond

kompensimi, proces i cili ka përfunduar së shqyrtuari nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në muajin dhjetor 2015, duke vendosur rrëzimin e padisë së depozituar nga këto shoqëri sigurimi.

Pavarësisht këtij procesi, nga ana e Autoritetit, është kërkuar që këto shoqëri sigurimi të përmbushin detyrimin dhe vetëm me përfundimin e procesit gjyqësor me vendim të formës së prerë, do të rishqyrtohen shumatat e paguara.

Pavarësisht këtij procesi, nga ana e Autoritetit, është kërkuar që këto shoqëri sigurimi të përmbushin detyrimin dhe vetëm me përfundimin me vendim të formës së prerë të procesit gjyqësor, të rishqyrtohen shumatat e paguara.

Mbi zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve

Paketa e masave stabilizuese e miratuar për tregun e sigurimeve përfshin:

- Rivendosjen e menjëhershme të financimit të Fondit të Kompensimit duke i kërkuar shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës të financojnë detyrimet e papaguara;
- Vendosjen e kërkesave ligjore për mbajtjen dhe financimin e një rezerve monetare në llogari qëllimore që do të përdoret vetëm për pagesat e dëmeve të produktit MTPL.

Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2015 ky tregues ka ardhur në rënie krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 67% për këtë periudhë nga 79% për 31.12.2014.

Tabela 6: Vlera e provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm

(Në mln. lekë)

Emërtimi	31.12.2013	31.12.2014	31.12.2015
Provigjone Teknike Bruto, MTPL	5,876	7,606	8,259
Provigjone Teknike Bruto, Jo-Jetë	7,980	9,663	12,410
Raporti i sigurimeve të detyrueshme ndaj totalit të tregut (në %)	74	79	67

Tabela 7: Struktura e provigjonit teknik bruto

(Në %)

Emërtimi	2012	2013	2014	2015
Provigjoni Teknik Bruto-Dëme MTPL	56	52	53	52
Provigjoni Teknik Bruto-Primi i Pafituar MTPL	44	48	47	48
Provigjone Teknike Bruto-MTPL	100	100	100	100

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Ruajtja e infrastrukturës së shërbimeve dhe pasurimi i sistemeve informatike të teknologjisë së informacionit (TI) me elementë të rinj kanë qenë gjithnjë ndër synimet e teknologjisë në AMF, duke i shërbyer mbikëqyrjes dhe analizës sa më efektive të tregut.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik përbëhet nga Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorike si dhe Regjistri i Dëmeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik të cilat kanë një bazë të plotë të dhënash me policat e shitura për sigurimet e detyrueshme motorike në Republikën e Shqipërisë, si dhe bazën e të dhënave të raportimi online për dëmet e ndodhura e cila ka edhe të dhënat bazuar në informacionin historik të akumuluar. Të dhënat e Qendrës përditësohen përmes regjistrimit *online* në kohë reale të policave të shitura nga shoqëritë e sigurimit dhe regjistrimit *online* të të dhënave për dëmet.

Në këtë bazë të dhënash kryhet raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Si pjesë funksionale e saj është edhe lidhja *online* me sistemin bankar i regjistrimit të policave. Ky ndërveprim me sistemet bankare mundëson zhvillimin dhe kontrollin e tregut të sigurimeve motorike dhe jep mundësinë e krijimit të standardeve në veprimet financiare që nga lëshimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik e deri në pagesën e dëmeve si rrjedhojë e tyre.

Në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, gjatë viti 2015, përfundoi zbatimi teknik i sistemit *Bonus-Malus*. Ky sistem bën të mundur tarifimin me fokus rrezikun në sigurimin motorik. Sistemi mundëson edhe integrimin e lidhjes me regjistrin e automjeteve nga i cili shoqëritë e sigurimit mund të marrin të dhënat e mjetit, të cilat e vendosin atë në një kategori të caktuar e cila nuk mund të ndryshohet. Kjo kufizon mundësitë e abuzimeve dhe gabimeve duke përmirësuar procesin e lëshimit të policës.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, përbën infrastrukturën bazë për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit *Bonus-Malus*. Ajo administrohet nga AMF dhe përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik *Online* i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar.
- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi e dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike.

Sistemi *Bonus-Malus*

AMF ka përfunduar zbatimin teknik të sistemit *Bonus-Malus*. Ky sistem bën të mundur tarifimin me fokus rrezikun në sigurimin motorik. Aktualisht agjentët e shitjeve të policave të sigurimit mund të kërkojnë të dhëna mbi automjetin dhe pronarin e automjetit nëpërmjet targës dhe numrit të shasisë. Në këtë fazë, përveç të dhënave të mësipërme të automjetit, sistemi gjeneron dhe dërgon edhe të dhëna rreth kategorisë së automjetit sipas informacionit bazuar në Regjistrin Kombëtar të Automjeteve, por agjentët nuk kanë të drejtë t'i ndryshojnë të dhënat duke parandaluar në këtë mënyrë abuzime të ndryshme. Një fazë tjetër, e përfunduar është dhe lidhja në kohë reale nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke ofruar numrin personal të pronarit të mjetit si çelës për kërkimin e historikut *Bonus-Malus* dhe kategorizimin e saktë të pronarëve në nivelet e rrezikut, i cili është në përdorim nga shoqëritë e sigurimit që nga data 3 mars 2015.

Me përfundimin e dy fazave sistemi është plotësisht funksional dhe parametrat e rrezikut, që janë numri i dëmeve dhe numri i viteve të plota TPL dërgohen drejt sistemeve të shoqërive të sigurimit duke bërë të mundur tarifimin me bazë rreziku.

AMF ka përgatitur dhe draft-rregulloren përkatëse për zbatimin e sistemit *Bonus-Malus*, e cila pritët të miratohet në kuadrin e ndryshimeve të Ligjit të nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, ku parashikohet edhe përfshirja në ligj i aplikimit të këtij sistemi në mënyrë të detyruar nga shoqëritë e sigurimeve në përllogaritjen e tarifave të primeve.

Sistemi *Bonus-Malus*

Sistemi *Bonus-Malus* prezanton një skemë universale të vlerësimit të tarifës për policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, ku për çdo rinovim të policës së sigurimit, për cilindo të siguruar, në varësi të dëmeve të ndodhura gjatë periudhës së mëparshme të sigurimit, përllogaritet koeficienti që do të aplikohet mbi tarifën bazë të sigurimit. Ky koeficient do të ndikojë në rritjen ose uljen e vlerës së tarifës së sigurimit, respektivisht nëse i siguruari ka bërë dëme ose jo gjatë periudhës së siguruar.

Sistemi *Bonus-Malus* pasqyron profilin e riskut, duke individualizuar tarifat e primeve. Kjo nënkupton, nëse i siguruari, përfshihet në një nga klasat e *Bonusit*, primi do të zvogëlohet dhe e kundërta do të ndodhë nëse përfshihet në klasat e *Malusit*, në varësi të historikut të dëmeve që i siguruari do të ketë për një periudhë të caktuar.

Autoriteti në bashkëpunim me palët e interesuara kanë përcaktuar algoritmin si dhe numrin e klasave të sistemit *Bonus-Malus*. Konkretisht sistemi është i përbërë nga 18 klasa, ku në mënyrë konvencionale klasa 1 do jetë klasa në të cilën të siguruarit do pagujnë më pak prim dhe klasa 18 më penalizuesja. Me fillimin e zbatimit të sistemit të gjithë të siguruarit do të caktohen në klasën 13, të cilës i përket koeficienti *Bonus-Malus* i barabartë me 1, në vijim klasa që i është shënuar një të siguruari për periudhën e sigurimit është e përcaktuar nga klasa prejardhëse dhe nga numri i dëmeve të raportuar të një viti më parë. Secilës klasë i përket një koeficient primi i veçantë β_P , ku P nënkupton numrin e klasave dhe $\beta_1 \leq \dots \leq \beta_{18}$.

Sistemi *Bonus-Malus* për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL do të konsistojë në:

- Uljen e klasës së riskut me një klasë në rastet e të siguruarit që nuk shkakton asnjë dëm gjatë vitit të kontratës;
- Rritjen e klasës së riskut me: 2 (dy) klasë nëse i siguruari bën një dëm gjatë vitit të kontratës; 5 (pesë) klasë nëse bën dy dëme, etj.

Zbatimi i sistemit *Bonus-Malus* nga ana e të siguruarve do hyjë në fuqi me miratimin e ndryshimeve të Ligjit të nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, ku parashikohet edhe përfshirja në ligj i aplikimit të këtij sistemi në mënyrë të detyrueshëm nga shoqëritë e sigurimeve në përllogaritjen e tarifave të primeve.

Gjithashtu, sistemet e TI në AMF janë në bashkëveprim të vazhdueshëm me sistemet TI pranë shoqërive të sigurimit për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e manualit të mbikëqyrjes.

Sistemi i Administrimit të Informacionit

AMF dhe shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në treg kanë në përdorim të vazhdueshëm sistemin “AMF In-Reg” i cili përbëhet nga një platformë raportimi *online*, nëpërmjet së cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

Ky sistem për administrimin e informacionit është në përdorim dhe mirëmbajtje nga AMF. Sistemi përdoret edhe nga shoqëritë raportuese.

Licencime në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2015, aktiviteti licencues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në fushën e sigurimeve u fokusua në licencimin e veprimtarisë së:

- Brokerimit në sigurime;
- Agjentit në sigurime;
- Vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

Ndërmjetësimi në sigurime

Ndërmjetësimi në sigurime përfaqëson veprimtarinë tregtare kundrejt pagesave dhe komisioneve, të prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit ose risigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Veprimtaria e ndërmjetësimit kryhet nga agjenti dhe brokeri në sigurime.

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime ushtrohet nga agjentë ose shoqëri agjentësh, brokera dhe shoqëri brokerimi. Në procesin licencues të ndërmjetësve në sigurime, AMF në vazhdimësi është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në fushën e ndërmjetësimit të jenë të qarta, objektive dhe transparente. Në synim të këtij objekti, u hartua Rregullorja nr. 79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës" dhe Rregullorja nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime". Në këto rregullore është vënë theksi tek rritja e pofesionalizmit dhe integritetit të personave që do të ushtrojnë aktivitetin si broker apo agjent.

Broker në sigurime

Brokeri në sigurime negocion me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit sipas kërkesave dhe nevojave të tij, duke mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi. Brokeri në sigurime asiston të sigurveparin në ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, si dhe gjatë ndodhjes së ngjarjes së siguruar.

Zhvillimet në tregun e sigurimeve dhe nevoja për mbrojtjen e interesave të bizneseve dhe individëve në procesin sigurvepar kanë rritur interesin e subjekteve për licencim në tregun e ndërmjetësimit, veçanërisht në atë të brokerimit.

Gjatë vitit 2015, Autoriteti miratoi licencën e një subjekti të ri për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit për klasat e Jo-Jetës. Ndërkohë, numri i brokerave fizikë nuk ndryshoi në krahasim me fundin e vitit 2014.

Tabelë 8: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime

(Në numër)

<i>Statusi i brokerit</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2014</i>	<i>Licenca të reja në 2015</i>	<i>Rinovim licence në 2015</i>	<i>Tërhequr licenca në 2015</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2015</i>
<i>Shoqëri brokerimi</i>	8	1	-	-	9
<i>Broker fizikë</i>	14	-	4	-	14

Sipas llojit të licencës, shoqëritë e brokerimit klasifikohen si më poshtë:

Tabelë 9: Shoqëri brokerimi sipas produkteve të sigurimit

(Në numër)

	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
<i>Shoqëri brokerimi Jo-Jetë</i>	3	7	5	5	5	4	5
<i>Shoqëri brokerimi Jetë dhe Jo-Jetë</i>	-	-	-	1	2	2	2
<i>Shoqëri brokerimi Jetë, Jo-Jetë dhe Risigurimi</i>	1	1	1	1	1	2	2
<i>Totali</i>	4	8	6	7	8	8	9

Veprimtaria e shoqërive të brokerimit konsiston në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit të Jetës ashtu dhe të Jo-Jetës si: *Shëndeti në Udhëtim, Garanci Oferte dhe Kontratë, Kasko, TPL, Karton Jeshil, Sigurimi Kufitar, Sigurimi nga zjarri, Sigurimi CAR, Sigurimi i Jetës me Kursim, Sigurim prone për kredi*, etj.

Nga raportimet e shoqërive të brokerimit mbi të dhënat statistikore për veprimtarinë që ato kryejnë, rezulton se në fund të vitit 2015, rreth 51.23% e totalit të primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve shiten me ndërmjetësimin e brokerave dhe rreth 38.42% e kontratave të sigurimit rezulton të jenë lidhur nga brokerat e licencuar. Në veprimtarinë e brokerimit mbizotëron ndërmjetësimi për produktet e Jo-Jetës me rreth 54.96% të primeve të shkruara bruto, i orintuar kryesisht nga sigurimi i detyrueshëm motorik. Ndërmjetësimi në produktet e Jetës është në nivelin 3.77%.

Komsioni i brokerimit kundrejt totalit të primeve të brokeruara, për vitin 2015, rezulton 4,5%.

Agjentë në sigurime

Gjatë vitit 2015 vazhdoi licencimi i personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jo-Jetës në emër dhe për llogari të katër shoqërive të sigurimit: shoqërisë “Insig” sh.a., “Sigal Uniq Group Austria” sh.a., “Albsig” sh.a. dhe “Ansig” sh.a.

Tabelë 10: Të dhëna mbi agjentët e licencuar

(Në numër)

<i>Statusi i agjentit</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2014</i>	<i>Rinovim licence 2015</i>	<i>Licenca të reja 2015</i>	<i>Përfunduar afati i licencës 2015</i>	<i>Tërheqje licence 2015</i>	<i>Të licencuar⁸ në fund të vitit 2015</i>
<i>Persona juridikë</i>	3	-	-	2	-	1
<i>Persona fizikë</i>	300	21	46	102	9	256

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime, në mënyrë profesionale dhe të paanshme, përcakton shumën e dëmshpërblimit që shoqëria e sigurimit detyrohet të paguajë ndaj personave të siguruar, si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, deri në limitin e përgjegjësisë të përcaktuar sipas kontratës së sigurimit.

Referuar Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, vlerësuesit të dëmeve mund ti revokohet licenca nëse:

- Ka shkelur kushtet e licencimit ose kërkesat e ligjit dhe akteve të Autoritetit;
- Nuk ushtron veprimtari brenda 6-mujve nga data e marrjes së licencës;
- Ka bërë vlerësime të gabuara dhe subjektive;
- Ka bërë vlerësime të pavërteta, shkelje të procedurave apo vlerësime që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me standardet profesionale;
- Ka paraqitur dokumente të falsifikuara ose të rrema për marrjen e licencës;
- Heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë.

Autoriteti për shkelje të dispozitave të këtij ligji mund të pezullojë licencën e vlerësuesit për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj.

Gjatë vitit 2015, AMF licençoi 8 vlerësues të tjerë të dëmeve në sigurime, si edhe rinovoi 7 licenca ekzistuese.

⁸ Numri gjithsej i agjentëve të licencuar në fund të vitit 2015 llogaritet si shumë e agjentëve të licencuar në fund të vitit 2014 + licenca të reja në 2015 + rinovim licence në 2015 – licencat që u ka përfunduar afati në fund të vitit 2015 – tërheqjet e licencave.

Tabelë 11: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar, sipas llojit të licencës dhe statusit

(Në numër)

Vlerësues dëmsh në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2014	Licencime të reja 2015	Rinovim Licence 2015	Përfunduar afati i licencës 2015	Të licencuar 2015
<i>Sipas statusit të vlerësuesit</i>					
I pavarur	31	3	4	2	36
I punësuar	29	5	3	8	29
Licenca jo aktive	5	-	-	1	4
<i>Sipas llojit të licencës</i>					
Për dëme materiale	6	-	-	2	4
Për dëme shëndetësore	9	3	-	-	12
Për dëme materiale dhe shëndetësore	50	5	7	9	53
Gjithsej vlerësues të licencuar	65	8	7	11	69

Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit,

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të nenit 116, pika 3, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe në kuadër të zbatimit të metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë riskun, Autoriteti, në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore, në kuadrin e projektit FIRST për reformën në tregun e sigurimeve, miratoi Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit" ku risitë e rregullores lidhen kryesisht me: rritjen e cilësisë së përcaktimit të kriterëve në procesin e lidhjes së marrëveshjeve të risigurimit nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe kriteret në përzgjedhjen e shoqërive risiguroese; përafrimi me kërkesat e Bashkimit Evropian në drejtim të trajtimit të risiguroesve, referuar gjendjes së tyre financiare; si dhe detaje mbi nivelin e cilësisë së kreditit (ose raportit të Aftësisë Pagueuse) të shoqërive të risigurimit pjesëmarrëse në marrëveshjet e risigurimit.

Kriteret e risigurimit

Autoriteti me vendim bordi nr 85/1, date 30.09.2015, miratoi rregulloren “Për Kriteret e Risigurimit”, ku janë reflektuar ndryshimet e nevojshme rregullatore në kuadrin e përshtatjes me ligjin e ri të sigurimeve, si dhe i është përafruar kërkesave të Bashkimit Evropian mbi trajtimin e shoqërive risiguroese pjesëmarrëse në marrëveshjet e risiguroese.

Përveç risive kryesore në lidhje me rritjen e cilësisë së përcaktimit të kriterëve në procesin e lidhjes së marrëveshjeve të risigurimit dhe përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian në drejtim të trajtimit të risiguroesve, rregullores i është bashkangjitur Aneksi 1 – ‘Përcaktimi i Nivelit të Cilësisë së Kreditit’, në të cilën janë të sqaruara në mënyrë të detajuar klasifikimi i shoqërive të risigurimit:

- i. Sipas shkallës së kreditit, të vlerësuar nga 4 (katër) agjenci klasifikuese;
- ii. Pa shkallë krediti, por të licencuar dhe mbikëqyrur nga regjime mbikëqyrëse të barazvlefshme me Regjimin Aftësia Pagueuse II (Solvency II) të Bashkimit Evropian;
- iii. Pa shkallë krediti dhe të pa licensuar e mbikëqyrur nga regjime mbikëqyrëse të barazvlefshme me Regjimin Aftësia Pagueuse II (Solvency II) të Bashkimit Evropian, si dhe shpjegimi, rast pas rasti, i çdo *Niveli të Cilësisë së Kreditit*.

Për portofole të veçanta siguriimi, shoqëritë kanë kryer transferim të rrezikut për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mundshme. Ky transferim është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit, kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi, apo mbulimit me risigurim fakultativ për kontrata të veçanta.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri sigurimi dhe kriterëve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.


Marrëveshjet risiguruese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim Humbje) dhe të formës proporcionale të tipit *Quota Share* e *Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2015 rezultojnë :

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën 2.82 miliardë lekë, ose 20% e primeve të shkruara bruto në këtë treg, me një rritje prej 342.73 milion lekë ose 13.85% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën 2.79 miliardë lekë ose 21.36% e vlerës së primeve të shkruara bruto, me një rritje prej 344.41 milionë lekë, ose 14.09% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën 28.31 milionë lekë ose 2.75% e vlerës së primeve të shkruara bruto, me një ulje prej 1.68 milionë lekë, ose 5.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014.


Ecuria e raportit të primeve të ceduara në risigurim mbi primet e shkruara bruto gjatë viteve 2011 deri në fundin e vitit 2015 jepet si më poshtë:

Grafik 12: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, total i tregut




Grafik 13: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jo-Jeta

(Në %)



Grafik 14: Primi i ceduar në risigurim/prime të shkruara bruto, Jeta

(Në %)



Ndër pjesëmarrësit kryesorë në programet e risigurimit, gjatë vitit 2015 për sigurimin e Jo-Jetës mund të përmendim VIG Re, UNIQA Re, Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Partner Re, Scor, Lloyd's Syndicates, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguruese e përfshirë në këtë program është Scor Global Life. Më shumë se 90% e partnerëve risigurues të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB- nga Standard & Poors, nga ku mbi 60% kanë klasifikim më të lartë se A.

1.3 Tregu i Letrave me Vlerë

Fondet e Investimeve

Industria e fondeve të investimeve në Shqipëri nisi aktivitetin në fillim të vitit 2012. Gjatë këtyre tre viteve në vijim ky sektor ka kaluar përmes ndryshimeve të rëndësishme strukturore, duke përbërë kështu një hap pozitiv përpara drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mbështetjes së tregut financiar në përgjithësi.

Në këto kushte, forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të administrimit të rreziqeve me të cilat përballen këto fonde dhe rritjes së transparencës së tyre, përbëjnë prioritetet e punës së mbikëqyrësit. Gjatë vitit 2015 në fokusin e punës mbikëqyrëse ka qenë ndjekja e zbatimit të rregullave që lidhet me njohjen, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit të fondeve të investimeve nga ana e shoqërive administruese të tyre, si dhe zbatimi i drejtë i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar në lidhje me vlerësimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2015, ka pësuar rritje. Në këtë treg vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj” i licencuar më datë 13.12.2011 dhe Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” i licencuar më datë 26.09.2012, të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest” sh.a.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve më 31.12.2015, vlera neto e aseteve të tyre arriti në 66.99 miliardë lekë, me një rritje prej 3.3 miliardë lekë ose 5.10% krahasuar me 31.12.2014. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare, të cilat përbëjnë 70.22% të aseteve të fondeve.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2015 është 32,149 me një ulje prej 1.59% krahasuar me 31.12.2014. Nga anëtarët në fond, rreth 99.99% e zënë investitorët individualë.

Tabelë 12: Vlera e kuotave të fondeve të investimeve

(Në lekë)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë</i>	<i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.'14</i>	<i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.'15</i>
Raiffeisen Prestigj	1,000 ⁹	1,207	1,290
Raiffeisen Invest EURO ¹⁰	14,000 ¹¹	15,024	15,042

Tabelë 13: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore të vitit 2015

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)			
Periudha	31.03.'15	30.06.'15	30.09.'15	31.12.'15
Asetet neto të fondeve	65,757	67,465	67,658	66,989
Totali i aseteve të fondeve	65,963	67,781	67,970	67,151
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	49,709	49,013	48,415	46,704
Obligacione të Shoqërive	1,637	1,540	1,208	2,037
Bono Thesari	8,651	11,021	12,028	11,696
Investime të tjera	819	502	499	682
Mjete Monetare	4,181	5,055	4,749	5,133
Asete të tjera	966	1,062	1,072	898
Totali i Detyrimeve të Fondeve	206	315	312	161

Tabelë 14: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve, 31.12.'14-31.12.'15

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj totalit (në %)	
Periudha	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'14- 31.12.'15	31.12.'14	31.12.'15
Asetet neto të fondit	63,736	66,989	5.10		
Totali i aseteve të fondeve	64,041	67,151	4.86	100	100
<i>nga të cilët:</i>		-	-		
Obligacione Qeveritare	48,895	46,704	(4.48)	76.35	70.22
Obligacione të Shoqërive	1,604	2,037	26.99	2.5	2.36
Bono Thesari	8,568	11,696	36.51	13.38	17.42
Investime të tjera	589	682	15.81	0.92	1.02
Mjete Monetare	3,411	5,133	50.49	5.33	7.64


⁹ Vlera fillestare në 31.03.2012

¹⁰ Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin 1euro = 140 lekë.


¹¹ Vlera fillestare në 22.11.2012.

Asete të tjera	974	898	(7.84)	1.52	1.34
Totali i Detyrimeve të Fondeve	306	161	(47.26)	0.48	0.24

Grafik 15: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.'14 (në %)



Grafik 16: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve 31.12.'15 (në %)



Inspektime pranë shoqërisë administruese të fondeve të investimit

Autoriteti gjatë vitit 2015 i kushtoi vëmendje vendosjes së rregullave dhe kritereve, të cilat synonin përmirësimin e procesit të administrimit të rreziqeve nga shoqëritë administruese për fondet e investimit nën administrim të tyre, në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të tregut gjithnjë në rritje.

AMF, gjatë 2015, ndoqi në vend procesin e zbatimit të rregullave “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve” dhe “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë”.

Gjatë procesit të inspektimit në vend iu vu theksi zbatimit të këtyre rregulloreve në fazën tranzitore, si domosdoshmëri për forcimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në vend, nëpërmjet përmirësimit të administrimit të rreziqeve me të cilat përballen këto fonde dhe rritjes së transparencës.

Gjatë vitit 2015, AMF në bashkëpunim me BSH, ka kryer inspektim të përbashkët pranë shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive Raiffeisen Invest sh.a. Ky inspektim nga ana e AMF, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe në përmbushje të rekomandimeve të FSAP-it për një mbikëqyrje efektive të konsoliduar, u përqëndrua në tre drejtime kryesore që lidhen me:

- Mbikëqyrjen efektive të veprimtarisë së shoqërisë, duke u fokusuar në politikat e investimit, procedurat e përzgjedhjes dhe miratimit të llojit të investimit, funksionimin e sistemeve të automatizuara që përdor shoqëria administruese për përllogaritjen e aseteve neto të fondeve të investimit dhe mënyrën e përllogaritjes së çmimit së kuotës, shlyerjet e kuotave të anëtarëve që tërhiqen nga fondi i investimit, mënyra e përllogaritjes së vlerës së shlyer si dhe çmimi i kuotës që përdoret në momentin e shlyerjes;
- Transparencën me investitorin, duke u fokusuar në administrimin e fondeve të investimeve kolektive, strukturimin dhe ndarjen e funksioneve të brendshme të shoqërisë, mënyrat dhe kushtet e shitjes së kuotave investitorit nga ana e shoqërisë administruese, procedurat e trajtimit të ankesave të klientëve nga shoqëria administruese;
- Përmbushjen e detyrimeve ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke u fokusuar në rregulloret, udhëzimet apo procedurat e brendshme që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, kryerjen e kontroleve nga auditues të brendshëm të shoqërisë dhe konkluzionet e mbajtura, raportimet e transaksioneve të dyshimta dhe transaksioneve në para fizike për vlerat sipas legjislacionit në fuqi.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF: Fokusi te zhvillimi i tregut të kapitaleve”

Këshilli i Ministrave, me vendimin e datës 9 shtator 2015 ka miratuar në parim, grantin për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së. Granti është dhënë nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Banka Ndërkombëtare për rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) është administratore e fondeve grant të qeverisë së Konfederatës Zvicerane.

Gjatë vitit 2015 u prezantua projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF: Fokusi te zhvillimi i tregut të kapitaleve”. Ky projekt synon të mbështesë AMF-në veçanërisht në forcimin e kapaciteteve për të mbikëqyrur tregun e fondeve të investimit. Ky projekt është mbështetur nga Banka Botërore e cila do të ndjekë edhe zbatimin e tij. Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (Trust Fund Grant).

Projekti është hartuar për të përballuar sfidat me të cilat po përballlet AMF dhe fushat që do të mbulojë ky projekt janë kryesisht:

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të fondeve të investimit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për tu përgatitur për emetimin e obligacioneve të shoqërive dhe qeverive lokale.

Gjatë vitit 2016 pritet të fillojë zbatimi i komponentit të parë, konkretisht me dy përbërës përkatës:

- Vlerësimi i strukturës, stafit dhe nevojave të trajnimit lidhur me fushën e mbikëqyrjes së fondeve të investimit;
- Vlerësimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe paketës mbikëqyrëse për fondet e investimit dhe obligacionet e shoqërive dhe qeverive lokale.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2015 u dominua në masën 72.73% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 27.27% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 86.66% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet "Blerje në tregun primar" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2015. Ato arritën përkatësisht në masën 67.27% dhe 16.62% kundrejt volumit të përgjithshëm të transaksioneve.

Investitorët individualë dominojnë në këtë treg duke kryer rreth 98.65% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Tabelë 15: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (mln. lekë)		Ndryshimi (në%)
	2014	2015	15/14-1
A Blerje në tregun primar	37,058	49,724	34.18
Individë	12,137	25,647	111.32
Persona juridikë	24,921	24,077	(3.39)
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	7,190	7,752	7.82
Individë	5,879	6,324	7.57

	<i>Persona juridikë</i>	1,311	1,428	8.91
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	3,330	2,689	(19.25)
	<i>Individë</i>	2,958	2,552	(13.72)
	<i>Persona juridikë</i>	372	136	(63.29)
D	Vendosje e bonos si kolateral	372	1,468	295.15
	<i>Individë</i>	45	889	1,864.74
	<i>Persona juridikë</i>	326	579	77.44
E	Shlyerje e vlerës nominale në maturim	11,952	12,988	2.81
	<i>Individë</i>	10,675	9,547	(10.57)
	<i>Persona juridikë</i>	1,276	2,740	114.69

Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Gjatë vitit 2015, platforma e GSRM-së, vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj duke siguruar rritje të transparencës në kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Në treg veprojnë 10 operatorë të licencuar nga AMF për të tregtuar letrat me vlerë të Qeverisë. AMF, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve, monitoron veprimtarinë e këtyre operatorëve dhe kujdeset që informacioni të jetë i përditësuar dhe në kohë reale. Platforma përfshin edhe një bazë të dhënash historike, e cila u vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Platforma e GSRM-së jep një informacion të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë. Gjatë vitit 2015, në platformën GSRM janë kryer 33,286 klikime, duke zënë rreth 8.27% të të gjitha vizitave në faqen zyrtare të AMF-së.

Platformat e tregtimit online

Platformat e tregtimit online u japin mundësi të interesuarve të investojnë në produkte financiare të bursave ndërkombëtare. Përgjithësisht, platformat e tregtimit *online* lejojnë tregtimin në tituj, (aksione, obligacione, derivative), tregtim në FOREX, apo tregtim në tregun e mallrave (naftë, metale të çmuara, etj). Investimi në këto platforma mbart rrezik të konsiderueshëm, prandaj investitorët duhet të tregohen të kujdesshëm, duke pasur informacionin e plotë dhe kulturën e nevojshme financiare.

Veprimtaria e rregulluar në treg e subjekteve që promovojnë produktet e platformave *online* krijon mundësinë për rritjen e ndërgjegjësimin të investitorit për vlerësimin e rreziqeve që shoqërojnë investimet në bursa, kufizon madhësinë e humbjeve të mundshme dhe ofron transparencë të plotë për shpjegimin e tyre në rast ndodhjeje.

Gjate vitit 2015, kanë vepruar 2 subjekte të licencuara në rolin e ndërmjetësuesit të platformave *online*. Aktualisht, platformat e tregtimit *online* janë në zotërim të shoqërive të brokerimit të licencuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Subjekti i licencuar njihet si agjent i brokerit të huaj.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 9879 datë 21.02.2008 “Për titujt” dhe Vendimit nr. 55 , datë 30.03.2011 ”Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, ka njohur veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë, që konsiston në: promovimin e veprimtarisë së brokerit; marrjen dhe transmetimin e urdhrave apo udhëzimeve nga klientët/klientët e mundshëm, si dhe ofrimin e këshillave për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me titujt dhe instrumentet financiare.

Sipas vendimit, agjenti vepron në emër dhe për llogari vetëm të një brokeri të licencuar të letrave me vlerë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo të një brokeri të licencuar nga Autoritetet e tjera mbikëqyrëse, anëtare të IOSCO-s, nënshkruese të MmoU.

Lista e plotë të shoqërive të brokerimit të licencuara dhe të brokerave të licencuara gjendet në Shtojcën B të këtij raporti.

Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Gjatë vitit 2015, Autoriteti licenoi një shoqëri të re komisionere për të vepruar si broker në tregun e letrave me vlerë dhe njëkohësisht si agjent i lidhur i një shoqërie të huaj brokerimi. Kështu, numri i shoqërive komisionere të licencuara në këtë treg u rrit në 14 dhe numri brokerave fizikë të punësuar në shoqëritë komisionere në 19.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat, të licencuara nga AMF për të kryer këtë veprimtari.

Tabela 16: Subjekte të licencuara që operojnë në tregun e letrave me vlerë

(Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Shoqëri komisionere	13	13	13	13	14
Broker fizik në shoqëri komisionere	17	18	18	18	19
Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh.	8	8	8	8	8
Regjistruar aksionesh	1	1	1	1	1
Shoqëri këshillimi për investime në tituj	0	0	1	1	1
Këshilltar për investime në tituj	0	0	1	1	1
Agjent i lidhur	0	1	1	1	2

Miratimi i ofertës private të obligacioneve

Tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare

Segment potencial i tregut të letrave me vlerë është tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare. Emetimi i parë i obligacioneve daton në nëntor 2011. Deri më sot, këto obligacione janë emetuar nëpërmjet ofertës private. Karakteristikat e këtyre obligacioneve janë: interesi fiks, kuponi gjashtë-mujor, afati i gjatë i maturimit. Gjatë vitit 2015, u miratua prospekti i një shoqërie për emetim obligacionesh me oferte private në shumën rreth 513 milionë lekë.

Ofertë private e obligacioneve

Tregu i obligacioneve u ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre.

Ligji nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe Ligji nr. 10158 datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” përbëjnë bazën ligjore për rregullimin e emetimit dhe të tregtimit të obligacioneve.

Kjo bazë ligjore mbështet krijimin e një tregu aktiv dhe efektiv obligacionesh në Shqipëri.

Miratimi i dokumentit me informacionin kryesor për fondet e investimit

Në vitin 2015, Autoriteti miratoi dokumentin me informacionin kryesor (KIID) që u vihet në dispozicion investitorit për Fondin e Investimit “Raiffeisen Prestigj”, si dhe dokumentin me informacionin kryesor (KIID) që u vihet në dispozicion investitorit për fondin e investimit “Raiffeisen Invest Euro”.

Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin (KIID)

Ky dokument përmban në formë të shkurtuar informacionin e përshtatshëm rreth karakteristikave thelbësore të fondeve të investimit (përfshirë performacën e fondit në periudhat e mëparshme) dhe ndihmon investitorin të kuptojë natyrën dhe rreziqet e investimit, duke i dhënë mundësinë të gjykojë mbi vendimin e investimit në fond. Ky dokument i vihet në dispozicion investitorit nga Shoqëria administruese përpara nënshkrimit të kuotave të fondit.

1.4 Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Skema e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar me Ligjin nr. 10197 datë 10.12.2009 ka krijuar hapësirat e nevojshme për lehtësimin në plan afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre.

Zhvillimet në këtë treg, që nga hyrja në fuqi e ligjit kanë patur një dinamikë pozitive. Gjithsesi, vlera neto e aseteve të këtij tregu është në masë të papërfillshme kundrejt PPB në Shqipëri. Në këto kushte fokusi i punës së Autoritetit gjatë vitit 2015 e në vijim mbetet forcimi dhe zhvillimi i tregut të pensioneve private vullnetare. Kështu, janë identifikuar dy drejtime kryesore të punës për forcimin e këtij tregu. Së pari, në drejtim të zgjerimit të mbulimit dhe së dyti në drejtim të zbatimit të një kuadri të ri mbikëqyrje të këtij tregu. Me asistencën e BB, është ngritur një plan veprimi i cili do të ndiqet për zgjerimin e mbulimit, si dhe po bëhet e mundur ngritja e një metodologjie të re mbikëqyrëse drejt asaj me bazë rreziku e forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse për zbatimin e saj.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2015 tregon një total asetesh neto prej 928.74 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 299.59 milionë lekë (47.62%), krahasuar me 31.12.2014.

Gjatë vitit 2015 numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri administruese, përkatësisht “Raiffeisen Invest” sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Raiffeisen”, “SIGAL–Life Uniqa Group Austria” sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, si dhe “SiCRED” sh.a., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar SiCRED.

Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2015 ishte 12,559 anëtarë, duke shënuar rritje prej 4,068 anëtarësh, ose 47.91% krahasuar me fundin e vitit 2014.

Tabela 17: Tregues të fondeve të pensioneve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'14-31.12.'15
Asetet neto të tregut të FP	629.14	928.74	47.62


Asetet neto të tregut të fondeve të pensioneve private vullnetare kanë shënuar një tendencë në rritje ndër vite. Në vitin 2014 rritja e këtyre aseteve ka qenë me 44.69% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që në 31.12.2015 rritja e këtyre aseteve ka qenë me 47.62% krahasuar 31.12.2014.

Tabela 18: Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve


Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	(31.12.'15)
		Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL LIFE	5,486	468.47
RAIFFEISEN	2,583	324.30

SiCRED PENSION	4,490	135.97
TOTAL	12,559	928.74

Grafik 17: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.12.2015



Grafik 18: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 31.12.2015



Gjatë vitit 2015, totali i investimeve të fondeve të pensionit ka qenë 843.02 milionë lekë dhe këto investime konsistojnë në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë. Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 44.92% krahasuar me 31.12.2014.


Ecuria e investimeve gjatë tre viteve të fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 19: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensioneve

<i>(Në mln. lekë)</i>			
<i>Periudha</i>	<i>31.12.'13</i>	<i>31.12.'14</i>	<i>31.12.'15</i>
Totali i investimeve të FP	421.68	581.71	843.02

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit të cilat operojnë në treg është afatgjatë duke synuar në maturitete 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare siç mund të shihet dhe në grafikun më poshtë:

Grafik 19: Ndarja sipas maturitetit të investimeve të tregut të fondeve të pensioneve, 31.12.2015



Projekti “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend”

Në vitin 2014 Autoriteti në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (*FSAP*) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet FIRST Initiative (*Financial Sector Reform and Strengthening Initiative*) filloi zbatimin e projektit të asistencës teknike për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend. Objektivi i këtij projekti është mbështetja e zgjerimit të procesit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së pensioneve private, si dhe të kontribuohet në zgjerimin e shtrirjes së tregut të pensioneve private në një sistem pensionesh më të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm.

Projekti përqendrohet në dy komponentë bazë që janë rregullimi dhe mbikëqyrja, si dhe zgjerimi i tregut, duke kontribuar në ndërtimin e kuadrit të mbikëqyrjes mbi bazë rreziku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse; rishikimin e bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës; apo përcaktimin e një plani strategjik dhe veprimi për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Gjatë vitit 2015 ka vijuar zbatimi i projektit të asistencës teknike në fushën e pensioneve private vullnetare. Në kuadrin e këtij projekti u përgatit drafti i parë i plotë i Manualit të mbikëqyrjes me bazë rreziku, mbi bazën e diskutimeve të zhvilluara midis eksperteve të BB dhe atyre të AMF-së.

Sa i përket komponentit për zgjerimin e tregut të pensioneve, në muajin tetor të vitit 2015 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Institutin e Statistikave të Shqipërisë zhvilloi Konferencën “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – zgjerimi i mbulimit”, e cila shërbeu si një forum për diskutimin e problematikave që kanë të bëjnë me zhvillimin e këtij tregu.

Konferenca pasqyroj ecurinë e tregut të pensioneve private në Shqipëri, mundësitë dhe sfidat që paraqet zgjerimi dhe zhvillimi i këtij tregu në vend, duke dhënë një pamje të plotë të problematikave dhe objektivave që lidhen me sistemin e pensioneve përfshi pensionet shtetërore dhe private, raporti i tyre me ekonominë e vendit në tërësi, nevojat për reforma, mbështetja që zhvillimi i këtij sistemi merr nisur edhe nga politika fiskale në vend, si dhe të kontekstit botëror në të cilin Shqipëria bën pjesë dhe do të duhet t’i përshtatet.

Gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me INSTAT u krye vërtetimi për vlerësimin e qëndrimeve të punëdhënësve ndaj ofertës së planeve të pensionit profesional. Në konferencë u prezantua metodologjia dhe rezultatet e vërtetimit të gjerë të zhvilluar gjatë muajit qershor 2015 në terren, në 500 subjekte ekonomike private me mbi 20 të punësuar në të gjithë Shqipërinë, në lidhje me mundësinë e zgjerimit të tregut të pensioneve vullnetare në vend. Vërtetimi i cili ishte rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm të AMF-së me INSTAT dhe BB, ka dhënë disa orientime të rëndësishme për organizimin e fushatave edukuese dhe promovuese për të nxitur interesin për produktet e tregut të pensioneve private dhe për zhvillimin në tërësi të këtij tregu. Rezultatet e këtij vërtetimi, do t’i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë AMF-së dhe shoqërive administruese të fondeve të pensioneve për të organizuar strategjitë e tyre të veprimt, por këto rezultate do të jenë të përshtatshme edhe për autoritete të tjera politikëbërëse në fushën e tregut të pensioneve.

1.5 Masat Korrigjuese dhe Administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe të subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e tij parashikon masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në kohën e duhur, duke bërë të mundur ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit, mbrojtjen konsumatore dhe forcimin e rolit të AMF-së.

Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke reflektuar konkluzionet nga ushtrimi i mbikëqyrjes. Në vendosjen e masave administrative janë respektuar parimet e efektshmërisë, vazhdimësisë, proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikimit mbi interesat e të siguarve.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, masat e mbikëqyrjes janë marrë me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave që përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, duke ndërhyrë në kohë

për zgjidhjen e problemeve financiare që mund t'i ndodhin shoqërisë së sigurimit, apo subjektit të mbikëqyrur. Vlerësimi i rrethanave për marrjen e masave të mbikëqyrjes bëhet bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit.

Sipas këtij ligji, përveç masave të mbikëqyrjes, kundravajtjet administrative sanksionohen me gjobë, duke vlerësuar gjithashtu natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi interesat e të siguruarve. Dispozitat e këtij ligji kanë rritur gamën e subjekteve ndaj të cilëve mund të vendoset sanksioni me gjobë si: shoqëritë e sigurimit apo personat përgjegjës të shoqërive të sigurimit, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, agentit/shoqërisë së agentëve, brokerit/shoqërisë së brokerimit, aktuarit të autorizuar, vlerësuesit të dëmeve etj.

Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes, identifikimit të problematikave duke ndërmarrë masa përkatëse me qëllim zbatimin e tyre. Marrja e masave është bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumente, verifikim të informacionit, apo në shqyrtim të ankesave të depozituara.

Konstatimet e gjetura përfshijnë shkelje të dispozitave të ligjit në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, rregullat e menaxhimit të rrezikut, organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, etj. Në disa raste nëpërmjet masave administrative, Autoriteti ka diktuar ndërmarrjen e hapave të caktuar për zgjidhjen e problematikave të konstatuara brenda një afati të përshtatshëm kohor.

Autoriteti me qëllim zbatimin e masave të marra nga subjektet e mbikëqyrura, ndjek në mënyrë të vazhdueshme çdo raportim apo informacion që lidhet me korigjimin e situatës për të cilët është marrë masa si dhe monitoron çdo veprim të kryer nga subjekti që lidhet me situatën në fjalë

Për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2015, ka miratuar gjithsej 7 vendime për masa administrative si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiarë ashtu edhe nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti.

Vendimet e detajuara sipas llojit të masave administrative paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela 20: Lloji i masave administrative të marra nga AMF në tregun e sigurimeve, 2015

(Në numër)

Urdhër për eliminim shkeljeje	Plan biznesi	Plan masash për eliminim të shkeljeve	Rekomandim për rritje kapitali	Rekomandim për këshillin mbikëqyrës
5	1	3	2	1

AMF ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2015 kanë përfunduar gjykimin 3 çështje gjyqësore.

Tabela 21: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF, 2015

(Në numër)

<i>Totali</i>	<i>Të përfunduara</i>	<i>Në proces</i>
11	3	8

Gjatë vitit 2015, ka përfunduar gjykimi për tre çështje gjyqësore. Këto çështje lidhen me ankimin ndaj tre vendimeve të Bordit për heqje licence për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë pranuar ankimin, duke shfuqizuar vendimet e Bordit të AMF-së.

Gjatë këtij viti kanë vijuar të jenë në proces gjykimi 8 çështje, nga të cilat: 2 çështje kanë objekt padie marrëdhënie pune dhe çështjet e tjera lidhen me ankime të bëra nga subjekte të mbikëqyrura, konkretisht 3 çështje të ankimuara nga vlerësues dëmsh në sigurime, 2 nga shoqëri sigurimi dhe 1 ankim i bërë nga BSHS.

Kapitulli 2

RREGULLIMI I TREGJEVE FINANCIARE NËN MBIKËQYRJE

2.1 Veprimtaria e Bordit të AMF-së

Bordi i AMF-së, në përmbushje të funksioneve të tij, gjatë vitit 2015 ka zhvilluar 14 mbledhje dhe ka miratuar 151 vendime. Tabela më poshtë pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

Tabelë 22: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

<i>Llojet e vendimeve</i>	<i>Numër</i>
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	95
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	11
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare	10
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	7
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së	28
Vendime në tërësi	151

Vendimet e Bordit të Autoritetit kanë pasur si objektiv sigurimin e respektimit të ligjit, përmes rritjes së transparencës dhe besueshmërisë, duke shërbyer si garanci për subjektet e mbikëqyrura. Vendimet që zënë peshë specifike më të madhe mbeten vendimet e lidhura me tregun e sigurimeve. Ndër to, janë miratuar vendime për përcaktimin e nivelit të provigjoneve të shoqërive të sigurimit, për përcaktimin e vlerës së fondit të kompensimit, për miratimin apo ndryshimin e statuteve apo prospekteve të shoqërive të sigurimit, miratimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse apo bordeve drejtuese të shoqërive, si edhe miratimin e ndërmjetësve në sigurime. Mbështetur në analizat e treguesve financiarë, Bordi i AMF-së ka marrë edhe masa administrative në rastet e mosplotësimit të kërkesave të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, me vendimet e Bordit nr. 33 datë 28.05.2015 dhe nr. 107, datë 05.10.2015, u ngrit komiteti këshillimor i përbërë nga 2 ekspertë me qëllim draftimin e një dokumenti për zhvillimin strategjik të tregut të sigurimeve. Komiteti Këshillimor i Bordit të AMF do të hartojë një dokument që lidhet me zgjerimin dhe diversifikimin e tregut të sigurimeve të detyrueshme dhe atij vullnetar. Dokumenti do të përfshijë ndër të tjera instrumentat për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorit në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit, për zgjerimin dhe thellimin e tregjeve për produktet e sigurimit.

Me synim forcimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, Bordi i AMF-së miratoi rregulloren “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, si edhe ndryshoi disa akte të tjera nënligjore.

2.2 Aktiviteti rregullator

Gjatë vitit 2015, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare punoi për ndryshimin e tre ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e fushave të mbikëqyrura.

Ndryshimet e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

AMF gjatë 2015 vazhdoi punën për përgatitjen e ndryshimeve të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në zbatim të rekomandimeve të Progres Raporteve të BE-së, rekomandimeve të Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca”, si dhe rekomandimeve të dhëna nga misioni i përbashkët FMN dhe Banka Botërore në kuadër të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP). Gjatë procesit të hartimit të draftligjit, Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtësisht dhe në vazhdimësi me Shoqatën, si nëpërmjet zhvillimit të tavolinave të rrumbullakëta, konsultimeve, ashtu dhe nëpërmjet korrespondencës së vazhdueshme (shkresave, e-mail, etj.) dhe ka marrë në konsideratë një pjesë të sugjerimeve dhe komenteve të tyre, të cilat ishin në funksion të përmirësimit të bazës ligjore, rregullimit të mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjes konsumatore.

Bordi i AMF-së me Vendimin e tij nr 106, datë 05.10.2015 shqyrtoi projekt ligjin e hartuar dhe vendosi dërgimin e tij në Ministrinë e Financave për të filluar procedurën e miratimit të tij në Këshillin e Ministrave. Projektligji ju dërgua për mendim ministrive përkatëse të linjës, si dhe Bankës Botërore.

Në dhjetor 2015, Banka Botërore parashitroi komentet dhe sugjerimet e saj ku kërkohej rishqyrtimi dhe përfshirja e dispozitave të reja në lidhje me strukturimin, funksionim dhe organizimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe Fondit të Kompensimit.

Si rrjedhojë AMF njoftoi Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të dërgimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” në Këshillin e Ministrave, i parashikuar nga Ministria e Financave për dërgim brenda katër mujorit të tretë të vitit 2015, në mënyrë që të kishte kohën e nevojshme për reflektimin e komenteve të Bankës Botërore.

Gjithashtu, gjatë dhjetorit, AMF shqyrtoi dhe përgatiti përgjigjet për të gjitha komentet e Ministrive të linjës në kuadër të projektligjit, të cilat u reflektuan përkatësisht në projektligj.

Për sa më sipër projektligji do të dërgohet përsëri në Ministrinë e Financave për të vazhduar procesin e miratimit të tij në vitin 2016 pas përfundimit të procesit të rishqyrtimit dhe hartimit të dispozitave të reja të sugjeruara nga Banka Botërore.

Ndryshimet e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”

Me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore në kuadër të Programit FIRST Initiative Autoriteti finalizoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Ky projektligj u dërgua pranë Ministrisë së Financave së bashku me relacionin përkatës dhe tabelën e përputhshmërisë. Autoriteti ka punuar për përfshirjen e komenteve të dhëna nga institucione shtetërore si dhe Banka e Shqipërisë për aktin e propozuar.

Gjatë vitit 2015 filloi zbatimi për herë të parë i lehtësive tatimore për fondet e pensioneve vullnetare të parashikuara nga Ligji nr. 156/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Sipas këtyre ndryshimeve ligjore konsiderohen si të ardhura të përjashtuara:

- Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar;
- Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve.

Gjithashtu, fondi i pensionit vullnetar konsiderohet i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

Me anë të ndryshimeve të propozuara, AMF synon të rrisë shkallën e përafrimit të ligjit me direktivat e BE-së, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Në këtë kuadër iniciativa e ndërmarrë nga Autoriteti përmirëson dhe plotëson kuadrin ligjor në tregun e pensioneve vullnetare sipas modelit evropian dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Ndryshimet në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Duke vlerësuar zhvillimet e fondeve të investimit, veçanërisht strukturën e portofolit të investimeve dhe kushtet e tregut shqiptar, BB dhe FMN në kuadër të shënimeve teknike të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) rekomanduan hartimin e amendimeve në legjislacion aktual, me qëllim përfshirjen e dispozitave në lidhje me administrimin e rrezikut nga

ana e fondeve të investimit dhe qartësimit e përmirësimit të procedurave aktuale të pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave.

AMF, gjatë vitit 2015, hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”” të cila konsistojnë kryesisht në dy amendime të ligjit aktual:

- Përcaktimin e detyrimit të shoqërisë administruese për krijimin e një sistemi dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, si dhe saktësimin e kompetencave të Autoritetit për të vendosur rregulla për kuadrin e administrimit të rrezikut; dhe
- Përmirësimin e regjimit të pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave, si dhe saktësimin kompetencave të Autoritetit në këtë proces.

Këto amendime e vendosin theksin mbi detyrimin e shoqërisë administruese për krijimin e një sistemi dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme për administrimin e rrezikut. Ato i atribuojnë AMF-së kompetencën e nevojshme për të miratuar një kuadër të plotë rregullash për administrimin e rreziqeve në situata normale tregu dhe situata të stresit financiar. Ky proces është i rëndësishëm për mbrojtjen e investitorëve nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar skemat e investimeve kolektive, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

Aktet e Autoritetit në fushën e sigurimeve

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” Autoriteti vijoi punën për hartimin dhe miratimin e akteve në zbatim të këtij ligji. Gjatë 2015, u hartuan dhe u miratuan disa akte të reja të Autoritetit.

- Rregullorja nr. 18, datë 28.04.2015 “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, e cila ka për qëllim të përcaktojë parimet minimale mbi bazën e të cilave shoqëria e sigurimit ndërton sistemin e administrimit të rrezikut, si dhe harton tërësinë e politikave dhe proceseve që lidhen me përcaktimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rreziqeve;
- Rregullore nr. 19, datë 28.04.2015 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i llojeve dhe karakteristikave të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimit/risigurimit që ushtrojnë veprimtari siguri në klasat e Jo-Jetës, kategoritë e tjera të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike,

përcaktimi i rregullave për diversifikimin dhe kufizimin në lidhje me investimin e këtyre aktiveve si dhe rregullat për vlerësimin e këtyre aktiveve;

- Rregullore nr. 20, datë 28.04.2015 “Për procedurat e ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të aktiveve të shoqërisë së sigurimit”, objekti i së cilës është përcaktimi i procedurave të ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të një pjese apo të gjithë aktiveve duke përfshirë dhe veprimtarinë që lidhet me dhënien e huave dhe investimeve, të shoqërisë së sigurimit;
- Rregullore nr. 32, datë 25.05.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit ", e cila ka për objekt organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për rekrutimin e trajnuesve dhe zbatimin e programit të formimit profesional të drejtuesve dhe profesionistëve në tregun e sigurimeve;
- Rregullore nr. 34, datë 28.05.2015 "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit". Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e formës, mënyrës, përmbajtjes, listës, periudhës si dhe afateve kohore për përgatitjen nga ana e shoqërisë së sigurimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të detajuara mbi veprimtarinë e saj;
- Rregullore nr. 35, datë 28.05.2015 "Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave", qëllimi i së cilës lidhet me përcaktimin e rregullave për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave të depozituara në AMF, lidhur me pretendimet e të siguarve apo personave të tjerë të interesuar për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kushteve të kontratës së sigurimit, nga shoqëria e sigurimit;
- Rregullore nr. 36, datë 28.05.2015 “Për informimin e të siguarit apo personave të tjerë të interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për informimin e të siguarit apo personave të tjerë të interesuar për zhvillimet dhe ndryshimet ligjore, sipas të cilave shoqëria e sigurimit merr masat teknike dhe administrative për krijimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- Rregullore nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit” objekt i së cilës është përcaktimi i kriterëve, dokumentacionit të nevojshëm dhe procedurave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese të shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve;
- Rregullore nr. 38, datë 28.05.2015 “Për formatin e detajuar, minimumin e objektit dhe të përmbajtjes së raportit të auditimit, të shoqërisë së sigurimit”. Kjo rregullore synon të

përcaktojë elementët e nevojshëm mbi objektin, formën dhe përmbajtjen e raportit të auditimit bazuar në natyrën specifike të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;

- Rregullore nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime” e cila ka për qëllim të përcaktojë kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të kërkesës, të personave që paraqesin kërkesën për t’u pajisur me licencë për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime;
- Rregullore nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit dhe refuzimit të licencës”. Objekti i kësaj rregulloreje përfshin përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojë agjenti në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij, rregulla për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit nga bankat, degët e bankave të huaja, subjektet financiare jo banka dhe subjektet e tjera, si dhe nga dega e shoqërisë së agentëve të një vendi të huaj;
- Rregullore nr. 85/1, datë 31.08.2015 “ Për kriteret e risigurimit” e cila ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë;
- Rregullore nr. 110, datë 26.10.2015 “Për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”. Kjo rregullore synon përcaktimin e kërkesave minimale për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëria e sigurimit dhe risigurimit, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorit dhe palëve të tjera të interesit, nëpërmjet rritjes së transparencës në tregun e sigurimeve, si dhe për të nxitur qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e tregut të sigurimeve;
- Rregullore nr. 111, datë 26.10.2015 “Për metodën e llogaritjes së kufirit minimal të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës” objekti i së cilës është përcaktimi i metodës së llogaritjes së kufirit minimal të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës;
- Rregullore nr. 120, datë 26.11.2015 “Mbi kriteret, rregullat dhe procedurat për delegimin e disa funksioneve nga shoqëritë e sigurimit” e cila synon të përcaktojë kriteret, rregullat dhe procedurat për delegimin nga shoqëritë e sigurimit të disa funksioneve”;
- Rregullore nr. 127, datë 26.11.2015 “Mbi procedurat dhe afatet për licencimin, rinovimin, refuzimin, revokimin dhe pezullimin e licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime, si dhe kryerjen e testimit të njohurive” e cila ka si objekt përcaktimin e

procedurave dhe afateve të licencimit, rinovimit, refuzimit, revokimit, pezullimit të licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime, si person fizik apo person juridik, si dhe përcaktimin e rregullave për kryerjen e testit të njohurive që duhet të kalojë aplikanti për marrjen e licencës si vlerësues dëmsh në sigurime nga AMF;

- Rregullore nr. 137, datë 21.12.2015 “Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrjes, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”. Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurës, afateve dhe dokumentacionin e nevojshëm për miratimin nga Autoriteti të emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit;
- Rregullore nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit” e cila synon të përcaktojë rregulla për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit;

Me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes sa më efektive të aktivitetit të tregut dhe operatorëve, AMF bëri ndryshime në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 15, datë 20.03.2015. Këto ndryshime konsistojnë në përshtatje të bazës ligjore me ndryshimet e ligjit aktual si edhe me riformulime të përkufizimeve.

Aktet e Autoritetit në tregun e Letrave me Vlerë

Gjatë vitit 2015, për tregun e letrave me vlerë, AMF ka plotësuar dhe përmirësuar bazën ligjore duke synuar përafrimin me direktivat e Bashkimit Evropian. AMF në zbatim të detyrave të lëna nga misioni i FMN dhe BB për plotësimin e bazës rregullative të fondeve të investimeve si dhe harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e BE-së miratoi një akt të ri nënligjor si dhe ndryshoi disa akte ekzistuese.

AMF miratoi Rregulloren nr. 45, datë 30.06.2015 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave për administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve nga shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me synim forcimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) në vend, nëpërmjet përmirësimit të administrimit të rreziqeve me të cilat përballen këto fonde dhe rritjes së transparencës. Kjo rregullore është produkt i bashkëpunimit të AMF-së me Bankën Botërore.

Të ndryshuara:

- Ndryshime në Rregulloren nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion” ndryshuar me Vendim Bordi nr. 46, datë 30.06.2015.
- Ndryshime në Rregulloren nr. 131, datë 06.10.2011 “Mbi kodin e sjelljes të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 47, datë 30.06.2015.
- Miratimin e një ndryshimi në Rregulloren nr. 68, datë 26.05.2011 “Për dhënien e licencës, veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 68, datë 23.07.2015.
- Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të SIK, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 151, datë 21.12.2015.

2.3 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

Integrimi Evropian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë. Vendimi i Këshillit të Evropës të qershorit 2014 që i dha Shqipërisë statusin kandidat ishte si vlerësim për reformat e ndërmarra dhe shërbeu si një impuls pozitiv për të gjithë procesin e aderimit në Bashkimin

Evropian. Statusi kandidat është inkurajim për të përshpejtuar ritmin e reformave.

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) përcakton një angazhim të veçantë të Republikës së Shqipërisë: përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian, proces ky që duhet të përfundohet në dy faza 5-vjeçare, brenda vitit 2019.

Shqipëria ka bërë përpjekje pozitive për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis*. Legjislacioni aktual i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin evropian.

Në fushën e shërbimeve financiare jobankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e BE-së dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private.

AMF si institucion kontribues në këtë proces ka punuar intensivisht për të përkthyer përafrimin e kuadrit ligjor, gjë që nënvizohet edhe në Progres Raportin e fundit të BE-së.

Më datë 10 nëntor 2015, Komisioni Evropian publikoi Raport Progresin për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2014-nëntor 2015. Pjesë e këtij Raporti janë edhe vlerësimet për Kapitullin 9 - “Shërbimet Financiare”, ku Komisioni Evropian ka vlerësuar pozitivisht disa përparime në fushën financiare jobankare.

Konkluzionet e Progres Raportit të KE-së (tetor 2014-nëntor 2015)
(Kapitulli 9-Shërbimet Financiare)

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë **disa përparime** në këtë fushë. Për bankat dhe konglomeratet financiare është ndryshuar legjislacioni për koeficientin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Përgatitjet në infrastrukturën e tregut financiar, tregun e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit kanë mbetur në fazë të hershme. Vitin e ardhshëm:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) duhet të plotësojë strukturën e bordit në përputhje me ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Në Progres Raport në përgjithësi për fushën e **sektorit jobankar** vihet në dukje emërimi nga Parlamenti në muajin mars të kryetarit të ri të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pas ndryshimeve të vitit 2014 në Ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. AMF ka ndërmarrë hapa për rritjen e kapaciteteve të veta institucionale, por duhet të miratohet struktura e tij e re organizative dhe të plotësohen vendet vakante në bordin e tij. Në qershor është licencuar një institucion i ri financiar i mikro-kreditit.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës**, Raporti vlerëson progresin e arritur kryesisht në kuadrin legjislativ: *“AMF ka nxjerrë rregullore mbi parimet dhe procedurat që lidhen me kontabilitetin e kompanive të sigurimeve, duke përfshirë sistemet e kontrollit të brendshëm të riskut dhe detyrimet e likuiditetit. Gjithashtu ky autoritet ka miratuar rregulloret për njoftimin, korrigjimin dhe ndalimin e prospektuseve”*.

Raporti vlerëson punën e AMF-së edhe në fushën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit**, ku vë në dukje se: *“Vëllimi i fondeve të investimit ka vazhduar të rritet në 2014 dhe është dominuar nga letrat me vlerë të qeverisë, të cilat zinin 85% të aseteve totale. Janë miratuar rregulloret për administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve dhe për njoftimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*.

Hartimi i Raport Progresit të KE-së mbështetet edhe në kontributet e përgatitura nga Qeveria e Shqipërisë mbi përparimin dhe arritjet e institucioneve publike shqiptare në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë. Në këtë kuadër, Autoriteti në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, në Kapitullin 9 “Shërbimet financiare” ka pasqyruar qartësisht zhvillimet aktuale përsa i përket përafrimit të kuadrit ligjor, zhvillimeve dhe reformave në sektorin financiar për tregjet nën mbikëqyrje. AMF po në këtë proces ka dhënë kontributin e vet edhe në kapitullin “Kriteri Ekonomik”.

Gjatë vitit 2015, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me **Ministrinë e Integritetit Evropian** si institucioni koordinues në procesin e integritetit evropian. AMF ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Kyçi i suksesit të Shqipërisë në rrugën e integritetit evropian është zbatimi i shpejtë i reformave, përmes aktiviteteve të planifikuara, në një nga dokumentet bazë siç është Plani Kombëtar i Integritetit Evropian (PKIE) për periudhën 2015-2020, i cili shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

AMF, gjatë vitit 2015, ka marrë pjesë në përditësimin PKIE për periudhën **2016-2018** për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, si dhe ka përcjellë në Ministrinë e Integritetit informacione periodike për monitorimin e realizimit të PKIE 2015-2020 për kapitujt “Shërbimet Financiare” dhe “Kriteri Ekonomik”.

Një tjetër drejtim i punës së AMF-së ka qenë përgatitja dhe prezantimi i raporteve pranë Komisionit Evropian në kuadrin e zhvillimit të takimeve periodike midis Shqipërisë dhe BE-së, konkretisht takimi i gjashtë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri dhe i Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën” në muajin mars 2015.

AMF, në kuadër të raportimeve pranë Komisionit Evropian, në dhjetor 2015, mori pjesë për herë të parë në takimin e shtatë të **Nënkomitetit për “Çështjet Ekonomike-Financiare &**


Statistikat”, ku prezantoi raportin për tregun e letrave me vlerë dhe konkretisht atë të fondeve të investimeve, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legislative e rregullatore, me qëllim përafrimin me *acquis* e BE-së, forcimin e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e fondeve të investimeve, si dhe ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Direktiva *Solvency II* (Direktiva 2009/138/EC)

Më 1 janar 2016, u bë e zbatueshme *Solvency II*, korniza e re mbikëqyrëse për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit në Bashkimin Evropian. *Solvency II* do të rezultojë në një ndryshim të konsiderueshëm në kulturën e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit. Kapitalizimi i mirë i siguresve do t’i mundësojë sektorit përballimin e goditjeve të paparashikuara.

Duke nxitur një qeverisje dhe administrim të mirë të rrezikut, *Solvency II* rrit mbrojtjen e konsumatorëve të produkteve të sigurimit. Raportimi i harmonizuar si dhe dhënia në kohë e informacionit, ju garanton mbikëqyrësve disponibilitetin e informacioneve kyçe dhe ju mundëson atyre marrjen në kohë të masave të nevojshme. Gjithashtu ky regjim i ri nuk do të jetë një barrë për shoqëritë e vogla, në sajë të parimeve të proporcionalitetit të parashikuara në këtë direktivë.

Kronologjia e *Solvency II*



Direktiva e Shpërndarjes në Sigurime: Ndryshimet në rregullimin e ndërmjetësve në sigurime në BE

Më 14 dhjetor 2015, Këshilli i BE-së miratoi Direktivën e Shpërndarjes në Sigurime (IDD), e cila do të zëvendësojë Direktivën 2002/92/KE të Ndërmjetësimit në Sigurime (IMD), korniza e deritanishme ligjore për rregullimin e agjentëve, brokerave dhe ndërmjetësve të tjerë në sigurime në BE. IDD u quajt fillimisht IMD II, por emri u ndryshua në shtator 2014 për të reflektuar fokusin e saj në rregullimin e shpërndarjes së produkteve të sigurimit edhe nga siguruesi i drejtpërdrejtë, në rastin ku nuk kemi ndërmjetësim.

Direktiva IDD kërkon nga të gjithë shpërndarësit që të veprojnë me ndershmëri, në mënyrë të drejtë dhe profesionale dhe në përputhje me interesin më të mirë të klientëve të saj. Kjo kërkesë vendos një standard të lartë të të gjithë shpërndarësit (përfshirë shitësit e drejtpërdrejtë dhe ato që ju ofrojnë shërbime klientëve profesionistë) që të marrin në konsideratë interesat e konsumatorëve gjatë veprimtarisë së tyre.

Zgjerimi i fushëveprimit

Ndërsa direktiva e Ndërmjetësimit (IMD) zbatohet për rregullimin e ndërmjetësve në sigurime, direktiva e re IDD vlen për rregullimin më të gjerë të "shpërndarësve" në sigurime. Kjo do të thotë se ajo do të zbatohet për:

- ***Të gjithë shitësit e produkteve në sigurime duke përfshirë edhe ata që shesin drejtpërsëdrejti te konsumatorët:*** aktualisht IMD përdoret vetëm për ndërmjetësit në sigurime;
- ***Çdo person, aktiviteti i të cilit konsiston në administrimin dhe performancën e kontratave të sigurimit, duke përfshirë edhe ata që veprojnë në emër të siguruesve – për shembull, menaxhimin e aktivitetit të dëmeve:***
- ***Ndërmjetësit që ofrojnë shërbime ndihmëse:*** gjithashtu fushëveprimi i direktivës së re është zgjeruar duke përfshirë ndërmjetësit 'ndihmës' në sigurime. Shtetet anëtare kanë të drejtë të kërkojnë që siguruesit dhe ndërmjetësit të marrin përgjegjësi më të madhe për ndërmjetësit që ofrojnë shërbime ndihmëse.

Kapitulli 3


QEVERISJA DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

3.1 Qeverisja dhe sjellja në treg

Tregu i sigurimeve

Gjatë vitit 2015, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo rimeërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në katër shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar emërime në organet drejtuese në tre shoqëri sigurimi.

Grafik 20: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit



Tabelë 23: Qeverisja e shoqërive të sigurimit-Statistika

	<i>(Në numër)</i>								
	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Nr. mesatar i aksionarëve	6.0	4.5	4.2	4.4	4.2	3.7	3.6	3.6	3.5
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës	5.0	3.6	3.4	3.6	4.0	4.2	4.1	4.1	4.0
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë	2.0	2.8	2.7	3.1	3.5	3.7	3.6	3.7	3.6
Nr. i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	3.0	3.0	2.0	2.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0


Tabelë 24: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

(Në numër)

<i>Emërtimi</i>	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shoqëri sigurimi	10	10	11	11	10	10
Aksionarë gjithsej	44	42	41	40	36	35
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>						
nën 10%	28	23	21	22	20	20
mbi 10% nën 20%	4	5	6	4	4	3
mbi 20% nën 33 %	2	3	1	3	2	2
mbi 33% nën 50%	1	1	3	1	1	1
mbi 50%	9	10	10	10	9	9
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës</i>						
Aksionarë të huaj	4	3	3	3	3	2
Aksionarë vendas	40	39	38	37	33	33
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:</i>						
Aksionarë individë	36	33	32	31	28	28
Aksionarë shoqëri	7	8	8	8	7	6
Aksionarë shteti	1	1	1	1	1	1


Grafik 21: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese për vitin 2015

(Në %)




Grafik 22: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës

(Në %)



Grafik 23: Të dhëna për aksionarët sipas statusit

(Në %)



Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2015, në tregun shqiptar të sigurimeve pati ndryshime në numrin e aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit. Në muajin shtator aksionari Fondi Amerikano-Shqiptar i Ndërmarrjeve i shiti aksionet që zotëronte në shoqërinë e sigurimit të Jo-Jetës Sigal Uniqa Group Austria sh.a. duke bërë që në tregun shqiptar të sigurimeve të jenë të pranishme dy aksionarë të huaj, të dy me seli qendrore në Vjenë, Austri. Aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë:

- *Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe* me seli qendrore në Vjenë, Austri;
- *Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH* me seli qendrore në Vjenë, Austri.

Si rezultat i shitjes së aksioneve, prezenca e aksionarit të huaj *Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH* në shoqërinë e sigurimit Sigal Uniqa Group Austria sh.a. arriti në 86.93%.

Miratime të ndryshimeve statutoire të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2015, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutoire, si më poshtë:

Tabelë 25: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutoire


(Në numër shoqërish)

<i>Arsyeja e ndryshimit të statutit</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Statut i ri e ndryshime të tjera	2	2	2	6	6	2	6	4
Rritje kapitali	9	4	2	4	4	3	5	2
Ndryshim i strukturës aksionare	2	2	5	3	2	2	3	3

Tregu i pensioneve vullnetare

Gjatë vitit 2015, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo rime të përbërjes në përbërjen e këshillave administrativë në dy shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare.

Grafik 24: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive administruese të fondeve të pensioneve vullnetare



Tabelë 26: Qeverisja e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve-Statistika

	2011	2012	2013	2014	2015
Nr. mesatar i aksionarëve	1.7	1.7	1.7	1.7	2.0
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit të Administrimit	5.3	5.3	5.3	5.6	6.0
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit të Administrimit që nuk janë aksionarë	5.3	5.3	5.3	5.6	6.0
Nr. i Administratorëve me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	-	-	-	-	-

Tabelë 27: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve vullnetare
(Në numër)

Emërtimi	2012	2013	2014	2015
Shoqëri administruese	3	3	3	3
Aksionarë gjithsej	5	5	5	6
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>				
nën 10%	0	1	0	1
mbi 10% nën 20%	0	1	1	1

mbi 20% nën 33 %	1	0	0	0
mbi 33% nën 50%	1	1	1	1
mbi 50%	3	3	3	3


Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës

Aksionarë të huaj	0	0	0	0
Aksionarë vendas	5	5	5	6


Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:

Aksionarë individë	1	1	1	1
Aksionarë shoqëri	4	4	4	5

Grafik 25: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese në 2015
(Në %)



Grafik 26: Të dhëna për aksionarët sipas statusit
(Në %)



Miratime të ndryshimeve statutoire të shoqërive të fondeve të pensioneve vullnetare

Gjatë vitit 2015, AMF ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutoire, si më poshtë:

Tabelë 28: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutoire

(Në numër shoqërish)

<i>Arsyeja e ndryshimit të statutit</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
Statut i ri e ndryshime të tjera	0	0	1	2
Rritje kapitali	1	1	1	0
Ndryshim i strukturës aksionare	0	1	1	0

3.2 Mbrojtja dhe edukimi i konsumatorëve

Një ndër objektivat kryesorë të AMF-së është mbrojtja e konsumatorit në tregjet financiare jobankare të mbikëqyrura nga AMF. Për arritjen e këtij objektivi, Autoriteti ka në strukturën e tij një njësi funksionale të specializuar për trajtimin e problematikave që kanë konsumatorët në përputhje me kuadrin ligjor rregullator në fuqi. Ky objektiv realizohet përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të konsumatorit, krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave të trajtimit të ankesave të konsumatorëve, duke inkurajuar dhe rritur besimin e tyre në rolin e AMF-së.

Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” i mundëson konsumatorit informacionin e nevojshëm dhe transparencën e vazhdueshme, me synimin që të krijojë besimin dhe sigurinë për të bërë zgjedhjen e duhur. Autoriteti mbikëqyr çdo informacion promociional që ofrohet nga shoqëritë e sigurimit, me qëllim që ky informacion të mos jetë çorientues dhe disinformues për konsumatorin.

Autoriteti ka shqyrtuar dhe verifikuar ankesat e ardhura nga konsumatorët, duke kërkuar nga subjektet nën mbikëqyrje korrigjimin apo rishqyrtimin e çështjeve të ankimuara, apo shpjeguar konsumatorit rrugën ligjore në mënyrë sa më të qartë për të. Procedurat e AMF-së për trajtimin e ankesave të konsumatorëve fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimet ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontaktet e vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale të çështjes së ankimuar, etj


Gjatë vitit 2015, në Autoritet kanë ardhur 72 ankesa nga persona fizikë, ente shtetërore apo subjekte juridikë. Ankesat lidhen kryesisht me pretendime për pagesën e dëmshpërblimeve në sigurime që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, apo për pagesa nga Fondi i

Kompensimit, refuzim i dëmshpërblimit që rrjedh nga kontratat e shëndetit në udhëtim, garanci kontrate, etj.

Numri më i konsiderueshëm i ankesave lidhet me dëmet e fondit të kompensimit të cilat janë ende të papaguara nga ana e shoqërive të sigurimit. Një pjesë e këtyre ankesave nuk janë zgjidhur për shkak se fondi i kompensimit i miratuar nuk është i njëjtë me vlerën e detyrimeve të këtij fondi, vlerë e cila është e akumuluar për disa vite.

Grafik 27: Ankesat dhe zgjidhjet 2007-2015

(Në numër)



Autoriteti ka mbështetur ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, edhe duke marrë rolin e ndërmjetësuesit, në përputhje me rregullat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, veçanërisht në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve për shkak të paqartësive të krijuara nga komunikimi ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit, për informacione apo interpretime të kushteve të kontratës.

Autoriteti përdor një sërë mekanizmesh komunikimi dhe informimi të konsumatorit, pasurimi në vazhdimësi i të cilave inkurajon dhe rrit besimin e konsumatorit në rolin e tij.

Mekanizmat e AMF-së për realizimin e transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimin financiar

- Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve. Ky sistem përfshin numrin e komunikimit nëpërmjet telefonisë fikse, (355 4 2257 557) numrin e telefonit jeshil pa pagese për konsumatorin (0800 6969), sistemin e sms-ve falas për kontaktet (355 69 4060671) dhe adresën elektronike të e-mail (konsumatori@amf.gov.al)
- Faqja *online* e AMF-së www.amf.gov.al. Kjo pasqyron në mënyrë të vazhdueshme informacionin lidhur me:
 - Bazën ligjore të përditësuar për tregjet nën mbikëqyrje;
 - Njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit;
 - Subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë edhe formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv;
 - Raportet statistikore me periodicitet mujor, tremujor ose vjetor;
 - Informacionet edukuese për konsumatorin;
 - Njoftimet për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve.

Në vitin 2015, me qëllim mbrojtjen dhe informimin e investitorëve, Autoriteti publikoi në faqen e tij *online* një rubrikë me emërtimin “*Investitorë Kujdes*”. Informacionet e dhëna në të synojnë të tërheqin vëmendjen e të ndërgjegjësojnë publikun se ofrimi i shërbimeve financiare vjen vetëm nëpërmjet shoqërive të licencuara nga AMF.

Nëpërmjet nënndarjeve dhe rubrikave të veçanta në faqen *online* të AMF-së jepen operatorët e licencuar nga AMF në tregun e sigurimeve, në tregun e titujve dhe në tregun e pensioneve vullnetare.

3.3 Qendra Edukimit

Në plotësim të kuadrit ligjor dhe zbatim të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, AMF miratoi Rregulloren nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit”. Qendra e Edukimit e krijuar si pjesë e strukturës organizative të AMF-së, është një ndër iniciativat më të reja të ndërmarra nga Autoriteti. Nëpërmjet organizimit të trajnimeve për formim profesional, kualifikim profesional dhe edukim në vazhdimësi, Qendra synon të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve profesionale të drejtuesve dhe profesionistëve që operojnë në tregun e sigurimeve, duke mundësuar kështu zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët.

Në vitin 2015, AMF nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër, si dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve. Me Vendimin e Bordit nr 103, datë 30.09.2015 u miratua “Marrëveshja e Bashkëpunimit për Programin e Trajnimit Afatgjatë të Kualifikimit Profesional për Aktuar”. Kjo marrëveshje synon krijimin e bazave të bashkëpunimit për programet e trajnimit dhe kualifikimit profesional për aktuar dhe mbështetjen e tyre për edukimin në vazhdimësi.

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, Qendra e Edukimit gjatë vitit 2015 ka zhvilluar tre module trajnimi të programit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar, i cili pritet të përfundojë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2017.

Gjatë vitit 2015, Qendra e Edukimit ka organizuar gjithashtu trajnime të ndryshme për formim profesional për profesionistët që ushtrojnë veprimtarinë si broker dhe vlerësues dëmsh në sigurime. Informacioni për veprimtarinë e Qendrës dhe programet trajnuese gjendet edhe në faqen zyrtare *online* të AMF-së.

Tabelë 29: Profesionistë të trajnuar në formim profesional, organizuar nga Qendra e Edukimit gjatë vitit 2015

<i>(Në numër)</i>		
<i>Profesionistët</i>	<i>Kualifikim profesional</i>	<i>Edukim në vazhdim</i>
Aktuar	9	5
Vlerësues Dëmsh	33	17
Broker	14	-

Kapitulli 4

TRANSPARENCA DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

4.1 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Rritja informacionit cilësor të ofruar për tregjet financiare nën mbikëqyrje, edhe gjatë vitit 2015 ka qenë një ndër prioritetet e punës së AMF-së. Aktiviteti i AMF-së është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në median e shkruar dhe elektronike, por më gjerësisht në gazetatat me tirazh më të lartë. Pasqyrimi i informacioneve për tregun e sigurimeve dhe zhvillimet që lidhen me të, kanë qenë të përhershme në media. Ndryshimet në tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik, ecuria e procesit për tarifimin me bazë rreziku, mundësia e zbatimit të sistemit *Bonus-Malus*, etj ishin ndër temat më të pasqyruara në media. Gjatë vitit 2015, u zgjerua edhe pasqyrimi lidhur me projektin e filluar për sigurimin ndaj katastrofave natyrore dhe mundësitë që ofron tregu i sigurimeve në këtë drejtim në Shqipëri. Kjo mori më tepër mbulim edhe nga situatat e vështira natyrore në Shqipëri dhe rajon me përmbytjet që rritën vëmendjen e shoqërive të sigurimit drejt këtyre fenomeneve. Pasqyrim periodik në media kanë pasur edhe informacionet mbi zhvillimet në tregun e pensioneve private vullnetare, fondeve të investimeve dhe tregtimin e letrave me vlerë. Konferenca e organizuar nga AMF “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – zgjerimi i mbulimit” pati një pasqyrim shumë të gjerë mediatik me mbi 19 artikuj dhe lajme në gazeta dhe televizione në ditën e konferencës. Ky mbulim u shtri edhe në ditët në vazhdim duke përzgjedhur tematika dhe informacione specifike që lidheshin me sistemin e pensioneve vullnetare.

Komunikimet e Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive të Autoritetit me subjektet aktive në tregjet nën mbikëqyrje dhe grupet e interesit kanë pasur vëmendje të veçantë. Në këto takime është theksuar roli i tregjeve që AMF mbikëqyr dhe pesha e tyre në tregun financiar të vendit, zhvillimet legjislative, puna për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, për të cilat AMF po mbështetet edhe nga organizmat ndërkombëtarë. Në komunikimet e Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive me median janë theksuar edhe perspektivat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe angazhimi që AMF t’i vijojë komunikimet më tej, duke i shndërruar në një forum diskutimi dhe informimi për publikun dhe investitorët në tregjet financiare.

Gjatë vitit 2015 pasqyrimi mbi aktivitetin dhe tregjet që mbikëqyr AMF është rritur duke ndryshuar edhe formën prioritare të komunikimit nëpërmjet rritjes së klikimeve dhe marrjes së informacionit në faqen *online* të AMF-së. Kjo është e lidhur edhe me zhvillimet e medias në vend e cila po shkon gjithnjë e më tepër drejt digjitalizimit.


AMF komunikon edhe përmes faqes zyrtare të internetit, buletineve mujore informuese për tregjet e mbikëqyrura, botimeve periodike vjetore, fletëpalosjeve, etj. Faqja zyrtare *online*

www.amf.gov.al është pasuruar me informacion të përditësuar me zhvillimet më të fundit të tregjeve. Këto informacione janë mjaft të vlefshme si për shoqëritë e sigurimit ashtu edhe për publikun si konsumator i këtyre shërbimeve.

Gjatë vitit 2015 në faqen *online* të AMF-së ka pasur 402,435 klikime dhe mbi 31% e tyre kanë qenë vizitorë të rinj, që kanë hyrë për herë të parë. Duke ju referuar informacioneve të vendosur në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve lexojnë lajmet në faqen kryesore si njoftime periodike, publikime e informacione statistikore për tregjet nën mbikëqyrje. Këto informacione janë vrojtuar nga mbi 69% e vëzhguesve të faqes *online*. Legjislacioni, rregulloret, procedurat, vendimet e Bordit të AMF-së janë vrojtuar nga mbi 16% e vizitorëve të faqes *online*.

Grafik 28: Struktura e klikimeve në faqen *online* të AMF-së, 2015

(Në %)



Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si nga Italia, Kosova, SHBA dhe Anglia.

Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Manuali i Mbikëqyrjes me Fokus Risku
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar
- Fletëpalosje për tregjet nën mbikëqyrje

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

4.2 Bashkëpunimi institucional

Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Bashkëveprimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi AMF, edhe gjatë vitit 2015 ka thelluar marrëdhëniet me institucionet ekonomike të vendit, rajonit e më gjerë për zhvillimin e rregullimit të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare.

Gjatë 2015 një vend të rëndësishëm zuri bashkëpunimi dypalësh ndërmjet AMF-së dhe **Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave apo Agjencisë së Sigurimit të Depozitave**, si dhe shumëpalësh ndërmjet tyre në kuadër të Grupi Këshillimor të Stabilitetit Financiar (**GKSF**) (takimet tremujore) dhe të grupit teknik (takimet mujore). Thelbi i procesit të bashkëpunimit gjatë vitit 2015 ka qenë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të FSAP-it, veçanërisht i atyre rekomandimeve zbatimi i të cilave lidhet me fushat e veprimit të këtyre institucioneve, siç ishin paketa ligjore; trajtimi fiskal i produkteve të sigurimeve dhe të pensioneve; masat stabilizuese, etj.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve, dhe specifikisht për sigurimet e detyrueshme motorike, AMF ka punuar ngushtësisht me **Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit** si edhe **Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor**. Në sajë edhe të marrëveshjeve të realizuara më parë me këto institucione, bashkëpunimi ka mundësuar kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në funksion të zgjerimit të platformës të regjistrave elektronik në administrim si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 945, datë 2.11.2012, gjatë vitit 2015 ka bashkëpunuar ngushtësisht me **Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit**, e cila mundëson administrimin dhe ndërveprimin e bazave të të dhënave me institucione të tjera shtetërore. Ky bashkëpunim ka mundësuar lidhjen e drejtpërdrejtë me të dhënat e regjistrit të Gjendjes Civile dhe të dhënave të regjistrit të mjeteve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, në funksion të sistemit *BonusMalus*.

Në maj të vitit 2015, Autoriteti nënshkroi, marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni me **Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)**. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rritja e bashkëpunimit nëpërmjet institucioneve në shkëmbimin e informacionit, kryerjes së inspektimeve dhe trajnimeve të përbashkëta, në funksion të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose aktiviteteve të lidhura me to, si dhe rritjen e rolit mbikëqyrës, me qëllim forcimin e sistemit parandalues në vend. Kjo marrëveshje është fryt i një bashkëpunimi të efektshëm ndër vite në përmbushje të standardeve evropiane në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. AMF në bashkëpunim me DPPP ka zhvilluar trajnime dhe inspektime të përbashkëta për çështje AML/CFT në tregjet që mbulohen nga AMF.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e **Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (IAIS)**, që prej vitit 2001. Ky anëtarësim ka synuar të ndihmojë në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

Gjatë vitit 2015, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitetet e IAIS. Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së është anëtare e Nënkomitetit të Përfshirjes Financiare (*Financial Inclusion Subcommittee*) i cili promovon në veçanti tregjet dhe ekonominë në zhvillim lidhur me zbatimin e Parimeve Themelore të sigurimeve për të mbështetur rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve dhe forma të tjera të veçanta të sigurimit.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS

- Mbledhje të Nënkomiteteve të Punës, shkurt;
- Seminar: “*Aftësia paguese dhe standardet e kapitalit për siguruesit në nivel ndërkombëtar*”, prill;
- Mbledhje të Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Punës, maj;
- Seminari “*Aplikimin e teknikave të menaxhimit të rrezikut dhe modelet e brendshme*”, korrik;
- Mbledhje të Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Punës, shtator;
- Seminar “*Praktika të mbikëqyrjes me bazë rrezikun dhe ndërhyrja e hershme*”; tetor;
- Konferenca Vjetore, 2015 “*Roli i mbikëqyrësit në mbrojtjen e policëmajtësve, stabiliteti financiar dhe zhvillimi i tregut*”, nëntor;
- Mbledhje të Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Punës, nëntor.

AMF është anëtare me të drejta të plota në **Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO)** dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Ajo ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO (*European Regional Committee, ERC*) dhe e Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*).

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO

- Mbledhja Vjetore, 2015 “*Ndërtimi i një bote të re financiare*”, qershor;
- Mbledhjet e Komiteteve të IOSCOs (GEM dhe ERC), qershor;
- Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian, ERC, shtator;
- Seminar “*Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve: Sfidat kryesore në të ardhmen*” tetor;
- Seminar “*Aplikimi i parimeve të IOSCO-s*”, tetor.

AMF është anëtare e **Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS)**, që prej vitit 2006.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS

- Mbledhje të Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, qershor;
- Seminar i përbashkët IOPS/ IAIS: “*Kursimet globale të pensioneve, roli i strukturave private dhe publike dhe ndërtimi i sistemeve private të pensioneve*”, qershor;
- Mbledhja e përbashkët e Grupit të Punës së IOPS/OECD mbi Pensionet Private , qershor;
- Mbledhja e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore, tetor;
- Forumi Global OECD/IOPS mbi pensionet private, tetor.

Pjesëmarrja e AMF-së në këto aktivitete konsiston në angazhimin për hartimin e dokumenteve politike dhe studimore. Gjatë vitit 2015, AMF ka vazhduar kontributin e saj si pjesëmarrëse në plotësimin e dokumenteve dhe pyetësorëve të ndryshëm, duke dhënë informacion lidhur me praktikat e ndjekura aktualisht në tregun shqiptar të pensioneve private.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së është mbështetur edhe gjatë vitit 2015 nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët.

Banka Botërore, mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin në përmbushje të misionit themelor. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të FSAP, Autoriteti i mbështetur nga Banka Botërore dhe financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Zvicerane (SECO) prezantoi projektin e asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Projekti ka si qëllim të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të fondeve të investimeve, si dhe për t’u përgatitur për emetimin e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe qeverisjes vendore.

Këshilli i Ministrave me Vendimin e tij nr. 869 të datës 30.10.2015, ka miratuar në parim, grantin për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së. Granti është dhënë nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti do të jenë:

- AMF të pajiset me një metodologji dhe praktikë gjithëpërfshirëse të mbikëqyrjes për fondet e investimeve, si dhe manuale dhe mjete të tjera operative që lidhen me këtë mbikëqyrje;
- AMF të jetë në gjendje për të mbështetur zhvillimin e tregut të obligacioneve të korporatave dhe të qeverisë vendore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator;
- Forcimi i burimeve profesionale dhe njerëzore të AMF për të mbikëqyrur veprimtarinë e tregut të kapitalave përmes aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve *on-site* dhe *off-site*.

Gjithashtu, gjatë 2015 në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (*Financial Sector Reform and Strengthening Initiative*) AMF ka punuar për zbatimin e projektit të asistencës teknike për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend “Mbikëqyrja e pensioneve në Shqipëri dhe zgjerimi i mbulimit”. Projekti, i cili ka filluar në korrik 2014, përqendrohet në dy komponentë bazë që janë rregullimi dhe mbikëqyrja, si dhe

zgjerimi i tregut, duke kontribuar në ndërtimin e kuadrit të mbikëqyrjes mbi bazë risku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse; rishikimin e bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës; apo përcaktimin e një plani strategjik dhe veprimi për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Përsëri në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet FIRST Initiative (*Financial Sector Reform and Strengthening Initiative*) AMF ka punuar për zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën e tregut të sigurimeve. Projekti përmban tre komponentë kryesorë të cilat janë siguri i produktit MTPL, mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme, si dhe programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet dhe përmytjet.

Komiteti Moneyval, i Këshillit të Evropës

Në shtator të 2015 u zhvillua në Strasburg (Francë) Seanca e 48-të Plenare e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, mbi marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve nga institucionet ligjore dhe financiare shqiptare mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, me qëllim daljen nga procedura e monitorimit të vazhdueshëm. AMF ishte pjesë e delegacionit shqiptar.

Komiteti gjatë marrjes në shqyrtim të raportit të paraqitur nga autoritetet shqiptare e vuri theksin tek progresi i bërë nga Shqipëria në përputhshmërinë me kriteret teknike të metodologjisë së Financial Action Task Force (FATF) si dhe masat e marra kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Bazuar në raportin/sugjerimet e sekretariatit të Moneyval u vendos dalje e Shqipërisë nga procesi i monitorimit.

Vendimi i Moneyval mbi daljen e Shqipërisë nga monitorimi i vazhdueshëm u parapri nga vendimi i marrë në seancën e ICRG, mbajtur në Paris në 23-24 shkurt. Në raportin e grupit të punës në vend (ICRG Onsite Team), rezultoi se Shqipëria ka plotësuar të gjitha mangësitë e raportuara në vite nga FATF.

Vlerësimi është dhënë nga Guida Ndërkombëtare e Riskut të Shteteve dhe FATF, Task Forca për Aksionin Financiar, që janë të dyja organizata botërore të cilat bëjnë analizën e shteteve në këtë drejtim.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Komiteti Moneyval, AMF ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Në maj të 2015 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis AMF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP);
- Në qershor të 2015 është miratuar Rregullorja nr. 58, datë 30.06.2015 "Për kujdesin e duhur dhe për vigjilencën e zgjeruar nga subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e sigurimit të Jetës ose risigurimit, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, fondet e pensionit dhe tregtimin e titujve. Qëllimi i kësaj rregulloreje është marrja e masave për krijimin e sigurisë të mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar identitetin e konsumatorëve, për të kuptuar dhe testuar profilin e tij, biznesin e tij dhe veprimtarinë e tij, në luftën kundër parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- AMF me ndihmën e Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare ka nisur punën për hartimin e një Manuali Inspektimi AML/CFT. Drafti i parë është duke u diskutuar mes ekspertëve përkatës. Manuali thekson specifikisht rëndësinë e mbledhjes së informacionit dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe planifikimin e rregullt të inspektimeve dhe fushëveprimin e tyre, përpara ndërmarrjes së inspektimeve në vend.

Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC / USAID), ndër vite ka ndihmuar AMF në projekte të ndryshme, për forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator, si edhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Ky organizëm vazhdon të mbetet një ndër partnerët kryesorë të AMF-së, në drejtim të asistencës teknike.

AMF në bashkëpunim me FSVC organizoi tryezën e rrumbullakët “Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të autoriteteve homologe, mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve nga vendet e Evropës Juglindore, si Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Republika Serbe e Bosnje-Hercegovinës dhe Sllovenia. Takimi u përshëndet nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA Austri, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, njëherësh Drejtor i Komitetit të Buxhetit të IAIS. Në këtë tryezë u diskutuan mundësitë për koordinimin e strategjive rajonale lidhur me disa problematika në mbikëqyrjen në sigurime si licencimi, regjimi i aftësisë paguese, shkëmbimi i të dhënave, kujdesi për të dhënat konfidenciale, kërkesat për mbikëqyrjen e grupeve dhe atë ndërkufitare, si dhe roli i kolegeve të mbikëqyrjes.

Gjithashtu, në kushtet e zbatimit të metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus rrezikun, gjatë 2015 AMF në bashkëpunim FSVC organizuan seminarin e trajnimit me temë “Administrimi i rrezikut në sigurime”. Programi ishte parashikuar për personat që merren me administrimin e rrezikut në praktikën e përditshme me synim përgatitjen e tyre në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2015, AMF me mbështetjen dhe nën asistencën e grupit të ekspertëve të FSVC-së punoi për realizimin e Projektit në luftën kundër pastrimit të parave (*Anti money laundering, AML*). Qëllimi lidhej me zhvillimin dhe plotësimin e manualit të inspektimit për AML-në.

Në këtë kuadër AMF organizoi seminarin “Lufta kundër Pastrimit të Parave” për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave, ku u diskutuan specifikat e punës në luftën kundër pastrimit të parave në tregun e sigurimit. Kjo i shërben forcimit të rolit mbikëqyrës të AMF-së në inspektimet në vend, për të ndjekur përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërive me dispozitat e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave si edhe programet që duhet të kenë shoqëritë në këtë drejtim.

Bashkëpunimi rajonal

Edhe gjatë vitit 2015, bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit ka qenë mjaft i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së rolit të AMF-së për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jobankare.

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)**. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis të dy institucioneve që është në veprim prej vitit 2010 ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Në muajin nëntor u zhvillua një takim në Tiranë, me drejtues të ISA-kryesuar nga Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve.

Takimi u përqendrua në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe sidomos të shoqërive që e shtrijnë aktivitetin e tyre në të dy vendet. Ndër çështjet e diskutuara ishin masat mbikëqyrëse dhe përshkallëzimi i tyre, realizimi i inspektimeve të përbashkëta, forcimi i bashkëpunimit rajonal për të përmirësuar praktikatat e mbikëqyrjes dhe për t’i harmonizuar ato me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

AMF dhe **Komisioni i Letrave me Vlerë i Bursës së Maqedonisë** kanë që prej vitit 2005 një marrëveshje bashkëpunimi e cila u shërben të dy institucioneve. Në prill AMF në bashkëpunim me SEC-un e Maqedonisë organizoi *workshopin* “Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri” me përfaqësues nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë, të cilët zhvilluan një vizitë pune në Tiranë. Ekipi nga Maqedonia kryesohej nga Znj. Elizabeta Chingarovska, Presidente e këtij institucioni. Ndër çështjet e tjera që u trajtuan në takime dhe gjatë *workshopit* lidhur me zhvillimin e tregut të kapitaleve ishin: kuadri i plotë ligjor që rregullon dhe mbikëqyr tregun e letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve; infrastruktura këtij tregu dhe roli i AMF-së në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tij; platforma elektronike *online* e AMF-së për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë; ecuria e Shqipërisë në procesin e Stabilizim-Asociimit për tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së; direktivat evropiane që rregullojnë tregun e kapitaleve, sfidat e përpjekjet e Shqipërisë për zbatimin e tyre; rëndësia e zhvillimit të Bursës së Tiranës; zhvillimet e fundit në drejtim të rritjes së pavarësisë së Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij në tregjet

financiare. Takimi dhe *workshopi* u vlerësuan mjaft të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve midis dy institucioneve.

Veprimtaritë kryesore të bashkëpunimit institucional

CESEE – “Nisma Rajonale e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve”

- Takimi i 9-të - Fokus në krijimin e strukturave mbikëqyrëse efektive bazuar në risk, shkëmbimin e përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, mbulimi i kompensimit për dëmet jomateriale nga sigurimi i detyrueshëm motorik si dhe skemat e garancisë si një mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet, Budapest, Hungari, *maj*;
- Takimi i 10-të - Fokusi sfidat e mbikëqyrjes së degëve në BE, praktikatat e BE-së lidhur me mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe ndryshimet e pritura në legjislacionin e BE-së që lidhen me ndërmjetësit, monitorimi / kontrolli i cilësisë së auditimeve të jashtme, kërkesat për anëtarët e bordit dhe mbajtësit e funksioneve. Trebinje, Republika Serbe, Bosnja dhe Hercegovina, *tetor*.

USAID/FSVC

- *Workshop*: Administrimi i rrezikut në sigurime”, *janar*;
- *Seminar*: “Lufta kundër Pastrimit të Parave”, *prill*.

BB-CFR

- *Workshop*: “Auditorët dhe mbikëqyrësit partnerë për mbikëqyrjen bankare më efektive”, *shtator*;
- *Workshop*: “Rregullatorët mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”, *shtator*;

BB & SECO

- Prezantohet projekti mbi “Forcimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitalit”, *maj*;

EIOPA & BB

- *Workshop*: “Mbikëqyrja me bazë rreziku”, *shtator*;

EIOPA & ESMA & EBA

- *Seminar*: “Mbikëqyrja e grupeve dhe kolegjet mbikëqyrëse, *maj*;

EIOPA/ICIR/BB/Universiteti St. John (St. John’s University)

- Konferenca mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve: “Globalisht nën presion”, *shtator*.

“Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, (**CESEE**), ka vazhduar të mbështesë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira midis stafeve të autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve. Gjatë 2015 janë zhvilluar takimi i nëntë dhe i dhjetë i kësaj iniciative. Në takimin e 9-të të Iniciativës CESEE çështjet e trajtuara lidhen në krijimin e strukturave mbikëqyrëse efektive bazuar në risk, shkëmbimin e përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, mbulimi i kompensimit për dëmet jomateriale nga sigurimi i detyrueshëm motorik si dhe skemat e garancisë si një mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet. Në takimin e 10-të u trajtuan sfidat e mbikëqyrjes së degëve në BE, praktikatat e BE-së lidhur me mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe ndryshimet e pritura në legjislacionin e BE-së që lidhen me ndërmjetësit, monitorimi/ kontrolli i cilësisë së auditimeve të jashtme, kërkesat për anëtarët e bordit dhe mbajtësit e funksioneve.

Bashkëpunimi me autoritete homologe

Gjatë vitit 2015, Autoriteti ka pasur në vëmendje zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tij dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe, duke marrë pjesë aktive në takimet apo veprimtaritë e organizuara për njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit mbikëqyrëse dhe rregullatore, shkëmbimit të përvojave të ndërsjellta.

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**. Bashkëpunimi me FMA, është konsoliduar ndër vite edhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve, si edhe të stafëve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri. Mbi këtë bazë janë ndërtuar marrëdhënie të suksesshme ndërmjet dy institucioneve, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoje dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri.

Në këtë kuadër, Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, njëkohësisht Kryetari i Komitetit të Buxhetit të IAIS-it bëri një vizitë pune në muajin maj pranë zyra të AMF-së dhe zhvilloi takime me drejtues të AMF. Objekti i takimit lidhej me zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë gjatë vitit 2015, sidomos të shoqërive austriake të pranishme në Shqipëri proces ky që koordinohet tashmë në nivel rajonal nga FMA; ndryshimet strukturore të të dy autoriteteve mbikëqyrëse; zhvillimet ligjore, përfshirë mbikëqyrjen e grupeve dhe çështjet e sekretit profesional.

Që prej vitit 2014, AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse për këto grupe dhe ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së morën pjesë në mbledhjet e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Insurance Group (UIG) dhe Vienna Insurance Group (VIG).¹²

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve në muajin nëntor 2015 u zhvillua në Tiranë takim i përbashkët i nivelit të lartë midis tre autoriteteve, **Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**, **Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (ISO)** dhe AMF-së.

Takimi u përqendrua në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë gjatë vitit 2015, sidomos të shoqërive austriake të pranishme në Shqipëri dhe në rajon,

¹² Bordi Mbikëqyrës i EIOPA-s në Shkurt 2016 miratoi vlerësimin regjimit të sekretit profesional të AMF-së. Si rrjedhojë e vlerësimit pozitiv të këtij regjimi AMF do të bëhet pjesë e Kolegjeve Mbikëqyrëse të Grupeve të Sigurimit.

masat mbikëqyrëse dhe përshkallëzimi i tyre, çështjet e ekuivalencës lidhur me trajtimin e të dhënave që përbëjnë sekret profesional në kuadër të EIOPA-s (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve), mbështetja për qendrën e edukimit të ngritur pranë AMF-së, forcimi i bashkëpunimit, duke përfshirë edhe tregun e pensioneve private vullnetare, si dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal për të përmirësuar praktikën e mbikëqyrjes dhe për t'u harmonizuar me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes. Takim u mbajt edhe në kuadër të një përpjekjeje rajonale iniciuar nga autoritetet mbikëqyrëse të Austrisë dhe Sllovenisë, për harmonizimin e praktikave të autoriteteve rregullatore të rajonit të Ballkanit Perëndimor për çështjet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të sigurimeve,

Gjatë vitit 2015, AMF thelloi bashkëpunimin me **Autoritetin Federal të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin)** në drejtim të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse. Kështu në muajin mars 2015 Autoriteti mori pjesë në një vizitë studimore organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Federale të Gjermanisë (BaFin), në kuadër të asistencës teknike në sektorin e sigurimeve dhe fondeve të investimeve. Gjatë vizitës u zhvilluan takime pune të nivelit të lartë me përfaqësues të AMF dhe BaFin. Temat e diskutimit kishin të bënin me rregullimin e sigurimit të Jetës, licencimin dhe mbikëqyrjen, stabilizimin e tregut të sigurimeve dhe organizimin efikas të fondit të kompensimit, aplikimi dhe përvoja e BaFin për stress-test, mbikëqyrja me bazë risku, çështje të lidhura me mbikëqyrjen e fondeve të investimeve.

Kapitulli 5

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

5.1 Pasqyrat Financiare

Auditimi

Duke nisur nga viti 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të AMF-së auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buronte nga detyrime ligjore. Bazuar në ndryshimet e Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Bordi miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të Autoritetit.

Funksioni i auditimit të brendshëm në AMF kryhet nga një specialist auditimi, i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik, i cili raporton te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe te Bordi i Autoritetit. Në vitin 2015, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përmbushur të gjitha detyrat e planifikuara të auditimit. Në bazë të gjetjeve të auditimeve të kryera, gjatë vitit 2015, janë dhënë 5 rekomandime, të cilat u janë raportuar njësive të audituara, si dhe Bordit të AMF-së. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është nxjerrë për të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe këto urdhra janë vënë në zbatim.

Buxheti

Përcaktimi i buxhetit bazohet në dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. AMF edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar të financohet tërësisht nga burimet e veta.

Pasqyrat financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015 janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Të dhënat e detajuara paraqiten në raportin e ekspertit kontabël të regjistruar të pavarur në shtojcën D.

Pasqyrat financiare të viteve të mëparshme, përfshirë vitin 2014, janë përgatitur në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushteti vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”.

Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar u bë në zbatim të gjetjeve të raportit të auditit të KLSH-së, si dhe rekomandimeve të auditit të pavarur. Këto standarde janë zbatuar edhe për pasqyrat financiare të viteve të mëparshme duke ndikuar në pozicionin dhe performancën financiare të raportuar më parë.

Duke qenë se vlerat e pasqyrave financiare të vitit 2014 janë riparaqitur, për t'u përshtatur me standardet ndërkombëtare, krahasimi i të dhënave financiare të Autoritetit të vitit 2015 me vitin paraardhës 2014 nuk paraqet në mënyrë të drejtë performancën financiare midis dy viteve.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, konceptit të materialitetit dhe të kontabilitetit mbi bazë konstatimesh.

Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2015 janë 255.15 milionë lekë ose 23% më shumë krahasuar me planin. Pjesa më e madhe e të ardhurave të realizuara, 254.63 milionë lekë, ose 99.8 % e tyre përftohen nga veprimtaria e subjekteve të mbikëqyrura dhe tarifat e licencimit apo miratimit, ndërsa pjesa tjetër ka ardhur nga gjrobat dhe interesat bankare, në masën 0.52 milionë lekë.

Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përfituara nga tarifat e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 81.9% të të ardhurave gjithsej.

Tabelë 30: Burimet e fondeve të AMF-së, 2015

(Në mijë lekë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2015</i>
1. Të ardhura nga veprimtaria	254,628
1.1 Të ardhura nga tregu i sigurimeve	210,036
1.2 Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve	42,133
1.3 Të ardhura nga kontributet e shoq. admin. të fondeve të pensioneve pri	489
1.4 Të ardhura nga Qendra e Edukimit	1,970
2. Të ardhura nga gjocat dhe interesat bankare, etj.	520
Totali (1+2)	255,148

Tabelë 31: Përdorimi i fondeve të AMF-së, 2015

(Në mijë lekë)

<i>Emërtimi</i>	<i>2015</i>
1. Shpenzime funksionimi	143,880
1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	87,429
1.2 Shpenzime operative	56,451
2. Investime	7,290
3. Fond rezervë	78,829
4. Fonde të regjistruara për periudhat e ardhshme	25,149
Totali (1+2+3+4)	255,148

Gjatë vitit 2015 të ardhurat e përdorura gjithsej ishin 144 milionë ose 16% më pak se plani. Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 95.3% të shpenzimeve gjithsej. Shpenzimet për investime në vitin 2015 janë realizuar në masën 7.3 milionë lekë ose 6% më pak se plani.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2015, përmbante 6 procedura prokurimi me tenderim, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla. Të gjitha procedurat e prokurimit me tenderim janë realizuar me sukses.

5.2. Struktura organizative dhe kualifikimi profesional

Bordi i AMF-së, bazuar në ndryshimet e Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në muajin prill të vitit 2015 miratoi strukturën e AMF-së me Vendimin nr. 27, datë 28.04.2015 “Për miratimin e strukturës organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Modeli i strukturës së re u mbështet në strukturën ekzistuese, por u riformatua për të mundësuar mbulimin më të mirë të funksioneve të AMF-së, për të pasqyruar zhvillimet e tregjeve, si dhe detyrat e reja të Autoritetit. Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive, në parim, është garantuar një strukturë organizative fleksibël, me synim forcimin e kapaciteteve administrative të AMF-së, si një nga kërkesat e vazhdueshme të Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian.

Struktura e re u shoqërua me rritjen e numrit të punonjësve, i cili planifikonte për vitin 2015 një numër prej 72 punonjësish dhe deri në fund të vitit 2019 planifikon 97 punonjës. Në fund të vitit 2015, numri i punonjësve të AMF-së ishte 59 vetë. Shkalla e plotësimit të vendeve të punës, krahasuar me numrin e vendeve të punës sipas strukturës është 82%.

Në funksion të ndryshimeve strukturore, në muajin gusht 2015, Bordi i Autoritetit miratoi një sistem të ri pagash. Nëpërmjet Vendimit nr. 76, datë 28.7.2015, u miratua udhëzimi “Për caktimin e shpërblimit të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.


Parimet kryesore mbi bazën e të cilave u ndërtua sistemi i ri i pagave janë:

- **Pavarësia.** Autoriteti gëzon statusin e një institucioni të pavarur me vetëfinancim dhe buxheti i AMF-së është i pavarur nga buxheti i shtetit;
- **Motivimi i punonjësve dhe ruajtja e kapaciteteve profesionale të institucionit.** Funksionet rregulluese dhe mbikëqyrëse të tregut financiar jobankar kërkojnë një staf profesional të motivuar dhe të dedikuar në punë;
- **Standardet e institucioneve të tjera rregullatore mbikëqyrëse brenda dhe jashtë vendit.** Praktikant ndërkombëtare shërbyen për një orientim shumë të mirë të politikave që Bordi ndërmerr.

Bazuar në strukturën e re organizative, shpërndarja e punonjësve sipas funksioneve të AMF-së dhe profesioneve jepet si më poshtë:


Grafik 29: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore sipas njësive

(Në %)



Grafik 30: Struktura e punonjësve sipas profesionit

(Në %)




Struktura e re organizative u ndërtua drejt theksimit të tiparit vertikal (sipas tregjeve), por duke ruajtur thelbin e ndarjes funksionale (horizontale). Tre ndarjet kryesore që identifikohen janë (1) sigurimet, (2) pensionet private vullnetare, (3) fondet e investimeve dhe tregu i kapitaleve. Në njësitë që kryejnë mbikëqyrjen financiare ushtrohet i gjithë cikli mbikëqyrës që nënkupton mbikëqyrjen nëpërmjet sistemit të raportimit dhe analizës (*off-site*) dhe inspektimeve në vend (*on-site*). Kjo do të thotë që në ndryshim nga struktura e mëparshme, AMF ka krijuar njësi

strukture me punonjës të dedikuar për mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe atyre të fondeve të investimeve dhe pensioneve private.

Në vitin 2015, AMF krijoi një njësi të re në strukturën organizative që është Qendra e Edukimit. Një nga risitë që solli ligji i ri i sigurimeve dhe risigurimeve ishte edhe ngritjen dhe funksionimi i qendrës së edukimit të profesionistëve të fushës, si domosdoshmëri e rritjes cilësore të këtij tregu.


Grafik 31: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës

(Në numër)



Grafik 32: Struktura e punonjësve sipas diplomimit

(Në %)



AMF edhe gjatë vitit 2015, është kujdesur të ruajë raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar në tiparet e tyre si arsimimi apo moshën. Ruajtja e nivelit prej disa vitesh të moshës

mesatare në 39 vjeç, ka sjellë harmonizimin më të mirë të cilësive të brezave të ndryshëm dhe ka siguruar transmetim të pandërprerë të njohurive dhe përvojës.

Politikat e burimeve njerëzore dhe kualifikimi profesional

Zhvillimi i burimeve njerëzore në AMF i shërben rritjes së kapacitetit profesional të punonjësve në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të Autoritetit. Në funksion të mbajtjes dhe tërheqjes së punonjësve të aftë e me integritet janë shfrytëzuar mekanizmat nxitës dhe motivues, ku përmendim ndërtimin e një sistemi të ri pagash që u zbatua në muajin gusht 2015, sistemin e ndihmave ekonomike, sistemin e diferencuar të shpërblimeve për arritjen e rezultateve në punë, zbatimin e planit profesional të pensionit vullnetar për punonjësit e AMF-së.

Qëllimi kryesor në fushën e burimeve njerëzore, edhe për vitin 2015, ishte zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve, motivimi i tyre për arritjen e objektivave si dhe punësimi i burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore. Në përmbushje të këtij synimi, në muajin tetor 2015 AMF miratoi dokumentin “Zhvillimi i Burimeve Njerëzore në AMF”.

Zhvillimi profesional i burimeve njerëzore në AMF realizohet nëpërmjet hartimit të planeve konkrete të trajnimit për punonjësit. Ky proces identifikon fushat e njohurive dhe aftësive profesionale që duhen të plotësohen, duke marrë parasysh kërkesat e së ardhmes dhe kërkesat individuale të çdo punonjësi të Autoritetit për trajnim. Drejtuesit e çdo njësie në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Qendrën e Edukimit mundësojnë kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

Gjithashtu, zhvillimi profesional i burimeve njerëzore në AMF kryhet edhe nga ana e vet punonjësve përmes shfrytëzimit të literaturës profesionale (bibliotekës së AMF-së), ndjekjes së trajnimeve *online* apo dhe transmetimit të njohurive tek kolegët e tyre, duke organizuar prezantime e takime diskutimi.

Punësimi i burimeve sa më të afta njerëzore vazhdoi të jetë përparësi në kuadrin e politikave të burimeve njerëzore. Për vitin 2015 nëpërmjet procedurave të punësimit u mundësuan punësimi 10 punonjësve të tjerë.

Gjithashtu në fushën e burimeve njerëzore për vitin 2015 janë rishikuar disa rregullore që disiplinojnë dhe normojnë punën në Autoritet.

Kualifikimi profesional

Në drejtim të kualifikimit profesional me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale, edhe gjatë vitit 2015 u ruajt përgjithësisht linja e specializimit të punonjësve në profilin ku ata punojnë. Programi i trajnimeve është ndërtuar në përshtatje me objektivat e institucionit dhe objektivat individuale për punonjësit. Aktivitetet e realizuara për vitin 2015, brenda dhe jashtë vendit, kanë

konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve prestigjioze ndërkombëtare në fushën financiare si: Banka Botërore (BB), USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri si edhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve, Shoqata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO); Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS); Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (NAIC), SEC, etj.

Aktivitetet dhe trajnimet më të rëndësishme përgjatë vitit 2015 kanë qenë programet e trajnimit që lidhen me forcimin e kapaciteteve institucionale për mbikëqyrjen me bazë risku, trajnimet në fushën aktuariale në kuadër të *Solvency II*, raportimet financiare sipas IFRS-ve, si dhe trajnimet lidhur me edukimin dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në vazhdimësi të politikës për rritjen e kualifikimit profesional të punonjësve, AMF ka vazhduar të ofrojë për punonjësit programin e trajnimit *online* “FSI Connect”, për 5 përdorues, kryesisht të departamentit të mbikëqyrjes.

5.3 Kuadri rregullator i AMF-së

Gjatë vitit 2015, në zbatim të Ligjin nr. 54/2014, datë 29.05.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”” u plotësua kuadri nënligjor i nevojshëm me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator dhe rritjen e efektivitetit të funksioneve të AMF-së.

Me Vendimin e Bordit nr. 27, datë 28.04.2015 u miratua struktura organizative, numri i punonjësve dhe përshkrimet e punës për punonjësit e AMF-së. Gjithashtu me Vendim Bordi nr. 76, datë 28.07.2015 u miratua edhe udhëzimi mbi pagat bazuar në kushtet e tregut, mundësinë e rregullimit të mbikëqyrjes më efektive të institucioneve financiare jobankare. Udhëzimi u bazua edhe në rekomandimet e Misionit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar në kuadër të Programit FSAP.

Bordi i AMF-së miratoi Rregulloren nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Bordit”, Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, Rregulloren e brendshme nr. 136, datë 21.12.2015 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave”. Për plotësimin e kuadrit rregullues u ndryshuan rregulloret ekzistuese si Rregullorja “Për marrëdhëniet financiare të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 30, datë 28.05.2015, Rregullorja “Për hartimin, ndjekjen, miratimin dhe

zbatimin e buxhetit të AMF-së”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 31, datë 28.05.2015, “Kodi i Etikës”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 131, datë 26.11.2015 dhe Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, ndryshuar me Vendim Bordi nr. 130, datë 26.11.2015.

Në përputhje me nenin 7, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur Programi i Transparencës për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i cili ndërton dhe rrit transparencën në punën e brendshme institucionale duke bërë publik të gjithë aktivitetin e tij në seksione të veçanta të faqes zyrtare të Autoritetit.

5.4 Teknologjia e Informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në AMF është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të informatizimit, si pjesë e pandarë e institucionit duke pasur si objekt pune zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike.

Gjatë vitit 2015, sistemet kryesore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në AMF kanë vijuar funksionimin duke siguruar mbështetjen e funksioneve bazë të Autoritetit si mbikëqyrja dhe rregullimi. Sistemet e TI në AMF kanë siguruar edhe koordinimin e punës me institucionet me të cilat AMF ka bashkëpunim për shkëmbimin e informacionit si Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithashtu, është synuar edhe në zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të brendshme të instaluar në AMF.

Përveç detyrave funksionale të lidhura ngushtësisht me funksionet e mbikëqyrjes, inspektimit dhe rregullimit, AMF gjatë vitit 2015 realizoi:

- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknike të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (Regjistri Elektronik *online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, Regjistri i Dëmeve, mirëmbajtja e sistemit të integruar *Bonus-Malus*);
- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve IT të ofruara nga AMF institucioneve si BSHS, DPSHTRR si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
- Përgatitjen dhe konfigurimin e mëtejshëm të infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AMF-së;
- Monitorimin e përditësimit e faqes zyrtare *online* të AMF-së;
- Zgjerimin dhe mirëmbajtjen e lidhjeve *online* dhe shkëmbimit të të dhënave të AMF-së në kuadër të përdorimit në rritje të sistemeve TI;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve të sigurisë, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së.

Sfida dhe projekte të ardhshme.

Në thelb drejtimet kryesore për zhvillim dhe sfidat e rëndësishme për AMF-në për vitin 2016 në lidhje me tregjet financiare që mbikëqyrën, mbeten të përqendruara te:

- Zbatimi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun, jo vetëm në tregun e sigurimeve, por edhe shtrirjen e kësaj metodologjie në tregun e fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve vullnetare private;
- Nxitja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare, nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Forcimi i punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit.

Brenda këtij kuadri të përgjithshëm, AMF për çdo vit zhvillon dhe përmirëson aspekte të ndryshme, që synojnë përmbushjen e objektivave kryesore.

Gjatë vitit 2016 vëmendja do të vijojë të përqendrohet në **stabilizimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen me fokus riskun** ku përfshihen specifikisht (i) masa e stabilizimit të financimit dhe përmirësimit të administrimit të fondit të kompensimit; (ii) masa e mbajtjes së rezervës monetare në shoqëritë e sigurimit; (iii) hartimi dhe zbatimi i strategjisë së edukimit të investitorëve të SIK; (iv) shtrirja e mbikëqyrjes me fokus riskun në të gjitha shoqëritë e sigurimeve; (v) forcimit të rregullave të administrimit të rrezikut të fondeve të investimeve; (iv) adresimi i mbikëqyrjes së grupeve; (vii) testimi për ndërtimin e sistemit të administrimit dhe vlerësimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimeve në bashkëpunim dhe nën orientimin e AMF-së

Nxitja e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje, pritet të mbështetet nga masat që do të çojnë në shtim të ofertës së produkteve dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare në aktivitetin e mbikëqyrjes. Në vijim, AMF po ofron bashkëpunimin me institucione të tjera të qeverisë për hartimin e legjislacioneve përkatëse për zgjerimin e gamës së produkteve në fushën e sigurimeve. Në fushën e pensioneve vullnetare po shqyrtohen mënyrat për rritjen e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve për të përdorur produktet që ofron tregu i pensioneve vullnetare. Ndërsa në fushën e fondeve të investimeve, AMF po ndjek me kujdes administrimin e rrezikut të likuiditetit, vlerësimin real të aseteve, si dhe përmirësimin e komunikimit e të informimit të investitorëve. Gjithashtu, AMF ka si objektiv hartimin e protokollit të mbikëqyrjes së përbashkët me Bankën e Shqipërisë për të mundësuar mbikëqyrjen e konsoliduar në ato veprimtari të institucioneve financiare ku përgjegjësia mbikëqyrëse është e të dy autoriteteve. Me përmbushjen e këtij objektiv synohet të reduktohen mundësitë e transferimit të rreziqeve nga një segment në një tjetër të sistemit financiar, apo që rreziqe të caktuara që mbeten pa u mbikëqyrur. Pra në thelb kontribuohet në rritjen e qëndrueshmërisë financiare.

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator vijon të jetë një objektiv i rëndësishëm, me synim rritjen e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes. Në tregun e sigurimeve, AMF do vijojë punën për ndjekjen e procesit të ndryshimeve të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe përfundimin e procesit të hartimit të rregulloreve në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Përsa i takon tregut të pensioneve vullnetare, AMF do të ndjekë procesin të miratimit të ndryshimeve në ligjin për pensionet si dhe hartimin e manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun që përfshin hapat e identifikimit, përkufizimit, klasifikimit dhe reagimit të rreziqeve në këtë treg. Në fushën e fondeve të investimeve, AMF do të punojë për hartimin e kuadrit rregullator sipas praktikave ndërkombëtare në zbatim të ndryshimeve në ligjin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective.

Në tërësi, vëmendja do të jetë në ***forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse*** në periudhë afatmesme, e cila pritet të realizohet përmes (i) plotësimit të vendeve të lira sipas strukturës organizative të AMF-së në përputhje me zhvillimet e tregut dhe punësimin e burimeve njerëzore sa më cilësore; (ii) kualifikimit profesional i stafit të AMF-së, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale në punë; (iii) trajtimit i punonjësve të AMF-së, për të mbështetur rritjen e cilësisë së tyre.

Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse do të përmbushet edhe nga zbatimi i tre projekteve të asistencës teknike që ka përfutur AMF nga Banka Botërore, për të tre tregjet që mbikëqyren dhe më konkretisht:

- Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve;
- Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve;
- Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve.

Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, kohë e cila është kërkuar të zgjatet nga Banka Botërore, dhe është strukturuar në tre komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. ***Sigurimi i produktit MTPL.*** Në këtë komponent synohet të hartohen kërkesa rregullatore për përcaktimin e rezervave për produktin MTPL, që janë të përshtatshme nga ana aktuariale dhe për t’i inkuadruar ato me praktikatat e mbikëqyrjes në vend. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) të sigurohet për konsumatorët kryerja e pagesave të duhura dhe në kohë në lidhje me dëmet për produktin MTPL; (ii) të ndiqen të njëjtat standarde në sigurimin MTPL; dhe (iii) të sigurohet vlerësim i përshtatshëm i aftësinë paguese për të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. ***Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme.*** Në këtë komponent synohet zhvillimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit të miratuar për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, paketës

së manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe kuadrit rregullator për sigurimin e jetës. Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapacitetit mbikëqyrës institucional të AMF-së. Ky komponent fokusohet në veprimtarinë e sigurimit të jetës dhe në këtë aspekt u punua me parimet aktuariale dhe rregullat për përcaktimin e provigjoneve matematike; aktivet në mbulim të provigjoneve matematike; mbrojtjen e konsumatorit në kontratat e sigurimit të jetës. Këto koncepte së bashku me manualët e mbikëqyrjes së sigurimeve të jetës apo të pronave do të përfundohen në një kuadër të miratuar rregullativ në vitin 2016.

3. *Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.* Në këtë komponent synohet plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore me elementët e sigurimit nga tërmeti dhe përmytja. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, pritët të vijojë puna së bashku me palët e tjera të interesit për hartimin e këtij ligji.

Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 18 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Rregullimi dhe mbikëqyrja.* Në këtë komponent objektivi është të hartohet kuadri i mbikëqyrjes me bazë rrezikun, si elementi bazë për zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje në fushën e pensioneve, si dhe përgatitjen e amendimeve të ligjit për pensionet private në frymën e kësaj metodologjie.

Në vitin 2016 objektivat e projektit lidhen me trajnimin e punonjësve të AMF-së për përdorimin në praktikë të manualit, vlerësimin e rreziqeve në tregun e pensioneve dhe kryerjen e inspektimeve pilot sipas metodologjisë së re në bashkëpunim me ekspertët e BB.

2. *Zgjerimi i tregut të pensioneve.* Objektivi në këtë komponent është zgjerimi i mbulimit me pensione të punëmarrësve në Shqipëri. Gjatë vitit 2016 do të vijohet me hartimin dhe zbatimin e strategjisë të mbështetur në rezultatet e vrojtimit dhe të planit të veprimit për zgjerimin e tregut të pensioneve, të publikuar gjatë Konferencës “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – Zgjerimi i mbulimit”, organizuar nga AMF dhe Banka Botërore. Kjo strategji fokusohet në rritjen e shkallës së njohurive përmes takimeve me punëdhënës, rritjen e shkallës së njohurive përmes fushatave edukuese me publikun, si dhe marrjen e masave për të forcuar besimin e publikut në AMF dhe në sektorin financiar në tërësi. Edukimi i vazhdueshëm i publikut në lidhje me rëndësinë e zgjerimit të tregut të pensioneve private vullnetare mbetet një nga prioritetet kryesore në funksion të zgjerimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
2. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Gjatë vitit 2016 pritet të fillojë zbatimi i komponentit të parë, konkretisht me dy nën komponentët përkatës:

- Vlerësimi i strukturës, stafit dhe nevojave të trajnimit lidhur me fushën e mbikëqyrjes së fondeve të investimit;
- Vlerësimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe paketës mbikëqyrëse për fondet e investimit dhe obligacionet e shoqërive dhe qeverive lokale.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit. Zbatimi i metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus rreziku kërkon mbështetje teknologjike. Në këto kushte prioritet i AMF do të jetë zhvillimi i formateve të reja në sistemin AMF In-Reg, në zbatim të metodologjisë së re të mbikëqyrjes dhe të dedikuara për mbikëqyrjen me fokus rreziku. Gjithashtu në fokus të AMF do të jetë dhe shtrirja e kësaj platforme të raportimit elektronik edhe në segmente të tjera të tregjeve financiare, si në tregun e letrave me vlerë dhe pensioneve private.